



USHTRIA



Viti i 69-të i botimit Nr. 50 (82651)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 25 dhjetor 2015

KREMTOHET 90-VJETORI I KRIJIMIT TË FORCËS DETARE

Forca Detare Shqiptare, një histori e lavdishme në shërbim të atdheut



» faqe 5-7

Redaksia e gazetës "USHTRIA" uron Forcat e Armatosura dhe të gjithë lexuesit e saj:

GEZUAR KRISHTLINDJET DHE VITIN E RI 2016!

DIREKTIVA E MBROJTJES 2016



» fa2-3



Intervista

Krenar dhe i vlerësuar për kohën që shërbeva në Forcat e Armatosura

Është me origjinë nga Vlora, por lindur në Shkodër. Pas përfundimit të Shkollës së Bashkuar së Oficerëve, në vitin 1980, shërbeu për 18 vite si oficer në Shkodër, ku dhe jetoi deri në vitin 2000. Pra ka jetuar për 43 vite në Shkodër. E quan veten me fat që është lindur dhe...

» faqe 8-9



Portret

Elis Arapi, oficer i dashuruar me detin

Në radhët e Forcave të Armatosura nuk janë të paktë djemtë dhe vajzat që shërbejnë me devotshmëri, me ndërgjegje dhe atdhedashuri të lartë. Por një bërthamë e mirë e tyre përveç këtyre vlerave të mrekullueshme, padyshim kanë kuptuar se pa një arsimim të plotë...

» faqe 10-11

MINISTRJA KODHELI PREZANTON DIREKTIVËN E MBROJTJES PËR VITIN 2016

Ministrja Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, prezantoi Direktivën e Mbrojtjes për vitin 2016. Në këtë prezantim ishin të pranishëm: shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandantët e Forcave, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA-së etj.

PRORITETET KRYESORE PËR VITIN 2016 DO TË JENË:

- Rritja e ndërveprueshmërisë dhe operacionalitetit;
- Përmbytja e angazhimeve në kuadër të Aleancës;
- Modernizimi i kapaciteteve dhe vijimi i përmirësimit të infrastrukturës së Forcave të Armatosura;
- Mirëmenaxhimi i burimeve të mbrojtjes dhe përmirësimi i mbështetjes për ushtarakët.



QENDRA E SIMULIMIT

Mbyllet me sukses stërvitja "Delfini-2015"

» faqe 4

QDK

Qendra e Doktrinës dhe Kërkimit bën bilancin e punës një vjeçare

faqe 12

NATO

Stoltenberg, mesazhi i fund vitit për trupat e NATO-s

faqe 14

MINISTRJA KODHELI PREZANTON DIREKTIVËN E MBROJTJES PËR VITIN 2016

Ministrja Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, prezantoi Direktivën e Mbrojtjes për vitin 2016. Në këtë prezantim ishin të pranishëm: shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandantët e Forcave, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA-së etj.

PRORITETET KYESORE PËR VITIN 2016 DO TË JENË:

- Rritja e ndërveprueshmërisë dhe operacionalitetit;
- Përbushja e angazhimeve në kuadër të Aleancës;
- Modernizimi i kapaciteteve dhe vijimi i përmirësimit të infrastrukturës së FA;
- Mirëmenaxhimi i burimeve të mbrojtjes dhe përmirësimi i mbështetjes për ushtarakët.



DIREKTIVA E MBROJTJES 2016

HYRJE

Ndryshimet dramatike në mjedisin e sigurisë dhe gjeopolitikës, ku kriza ekonomike, sulmet terroriste, zhvillimet në kufijtë lindorë dhe jugorë të Aleancës dhe emigracioni masiv, ndërthuren dhe krijojnë skenarë të rrezikshëm për vendin dhe aleancën. Për këtë, kërkohet vlerësim real i gatishmërisë së FA, me qëllim kontributin në rritjen e paqes e stabilitetit në vend, Aleancë, rajon e më gjerë. Nisur nga realiteti gjeopolitik, sfidat e mbrojtjes për vitin 2016 vijojnë të mbeten modernizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të afta për t'ju përgjigjur sfidave strategjike në përputhje me angazhimet e vendit tonë, zbatimin e dokumenteve strategjike, hartimi i doktrinave, rritja e ndërveprueshmërisë, menaxhimi efektiv i burimeve të mbrojtjes, rritja e dinjitetit të ushtarakëve, si dhe lufta pa kompromis kundër korrupsionit.

II. PRIORITETET KYESORE PËR VITIN 2016

1. Rritja e ndërveprueshmërisë dhe operacionalitetit;
2. Përbushja e angazhimeve në kuadër të Aleancës;
3. Modernizimi i kapaciteteve dhe vijimi i përmirësimit të infrastrukturës së FA;
4. Mirëmenaxhimi i burimeve të mbrojtjes dhe përmirësimi i mbështetjes për ushtarakët.

III. DREJTIMET KYESORE TË



PUNËS PËR VITIN 2016

Drejtimet ku do të fokusohet veprimtaria e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, për vitin 2016 do të jenë:

Zbatimi i dokumenteve strategjike:

Strategjia Ushtarake (SU) dhe Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FA 2016-2025, kanë krijuar një kuadër të ri konceptual e normativ, i cili do të orientojë dhe përshejtojë transformimin e mbrojtjes. Të gjitha strukturat sipas fushave të veprimtarisë së tyre, të harmonizojnë objektivat e tyre me ato strategjike, të hartojnë e përmirësojnë planet e veprimit dhe ato mbështetëse dhe të ndjekin e raportojnë me rigorozitet përbushjen e tyre.

2. **Planifikimi:** Procesi i planifikim-

programimit në përbushje të prioritetëve, të harmonizohet me planifikimin e mbrojtjes së Aleancës, në zbatim të paketës së Objektivave të Kapaciteteve (CT). Nisur nga koncepti i "një seti të vetëm forcash", të planifikohet dhe programohet zhvillimi i kapaciteteve të luftimit, mbështetjes së luftimit dhe mbështetjes me shërbime të luftimit, të cilat janë detyrim për aleancën (CT). Të planifikohet dhe shtrihet në vite përbushja e kriterëve të përdorueshmërisë dhe dislokueshmërisë së FT dhe të përfshihen elementët e grup-batalionit në programet e modernizimit. Të rriten njohuritë mbi procesin e planifikim-programimit, të hartohen programet e mbrojtjes sipas afateve dhe prioritetëve, të rishikohet lista e integruar e prioritetëve dhe programet e modernizimit

për periudhën afatmesme. Drejtuesit e strukturave të vlerësojnë me përparësi procesin e planifikimit duke u angazhuar personalisht në përbushjen e detyrimeve dhe përmirësimin e bashkëpunimit midis të gjitha strukturave të FA/MM. Gjatë vitit 2016, të vijojnë programet shumëvjeçare dhe të nisin programet e reja për përmirësimin, zhvillimin, trajnimin, stërvitjen, dislokimin dhe mëvetësinë e kapaciteteve të FA.

3. **Zhvillimi i kapaciteteve:** Kapacitetet e FA të përmirësohen dhe zhvillohen në përbushje të misionit e detyrave, SU dhe sipas konceptit të Aleancës për zhvillimin e kapaciteteve.

3.1. Prioritet kryesor të jetë zhvillimi i Grup-Batalionit (GB) me të

gjithë elementet e tij, për ta vënë në dispozicion të operacioneve të NATO-s në afatet e kërkuara. Fokusi të jetë batalioni i dytë i këmbësorisë dhe në kontributet e deklaruara në NRF/VJTF. Të vijojnë programet për kompletimin e b2k me personel, pajisje kritike dhe pajisje mbështetëse. Të intensifikohen stërvitjet për të arritur nivelin e kërkuar të gatishmërisë duke kontribuar në të gjithë spektrin e operacioneve të NATO-s, të fokusuar në zbatimin e Planit të Gatishmërisë për Veprim (RAP). Të hartohen planet e zhvillimit të elementëve mbështetës të grup-batalionit të këmbësorisë, dhe të hartohen apo rishikohen konceptet, kërkesat operacionale, propozimet teknike dhe projektet e reja, realiste dhe ambicioze për menaxhimin më efikas të burimeve në dispozicion. Të hartohen projektet e modernizimit me fokus rritjen e lëvizshmërisë, nivelit të mbrojtjes, fuqisë së zjarrit dhe zhvillimin e kapaciteteve mbështetëse për GB dhe për FT.

3.2. Të përmirësohen kapacitetet për vëzhgimin e hapësirës detare, kapacitetet reaguese dhe kapacitetet e patrullimit dhe ndalimit detar (boardingut). Të rritet sasia e orëve të patrullimit dhe të vlerësohet efektiviteti i tyre përkundrejt objektivave të synuar.

3.3. Të mbahen në gatishmëri operacionale helikopterët, personeli dhe kapacitetet e FAJ. Të rriten kapacitetet trajnuese dhe orët e fluturimit të pilotëve dhe kapacitetet për Vëzhgimin e Hapësirës Ajrore duke modernizuar Qendrën e Kontroll-Raportimit (QKR).

3.4. Të përmirësohen kapacitetet për

STAFI

Kryeredaktor:
Muharrem DARDHA

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA
Albert ZHOLI

Gazetarë:
Saimir ALIJA
Etleva SMAÇI

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ
Redaktore/Korrektore:
Anila DODA

ADRESA:
Ministria e Mbrojtjes,
Bulevardi "Zhan D'Ark"

sigurinë dhe mbrojtjen kibernetike.

4. Gatishmëria dhe operacionaliteti: Forcat e Armatosura, të përmirësojnë dhe mbajnë gatishmërinë për të reaguar dhe marrë pjesë në operacione në kohë paqe, krize dhe lufte. Të përcillet për miratim rregullorja e re e gatishmërisë, e cila të harmonizojë nivelet dhe normat e gatishmërisë së FA, me ato të NATO-s. Komandantët e forcave, të rrisin gatishmërinë e njëjësive dhe të zbatojnë në kohë programet për pajisjen, stërvitjen dhe modernizimin e tyre. Të përmbushet niveli i ambicies kombëtare dhe angazhimit për kontribute në operacionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB.

5. Modernizimi: Pajisja e njëjësive të deklaruara në NATO, me armatim të lehtë të këmbësorisë, është guri i themelit të një ere të re në modernizimin e FA. Të vijojnë zbatimin e programeve shumëvjeçare të modernizimit sipas prioritetëve, në blloqe të veçanta, për zhvillimin e kapaciteteve specifike të FA, përmbushjen e Objektivave të Kapaciteteve dhe rritjen e ndërveprueshmërisë. Të vazhdojnë projektet e automatizimit të mbrojtjes, pajisjes me armatimin e lehtë të këmbësorisë, pajisja me mortaja 60mm dhe 81mm, kompletin individual të luftimit, pajisjet e MADM, pajisjet EOD për togën NRF, pajisjet për zbulimin, pajisjet speciale për temperatura ekstreme, pajisjet mjekësore, mjetet e transportit, si dhe rritja e kapaciteteve për operacione në mbështetje të popullsisë civile, siguri i mirëmbajtjes për helikopterët dhe rritja e kapaciteteve biometrike në FA.

6. Rritja e ndërveprueshmërisë: Gjatë 2016, ndërveprimi të jetë prioritet për rritjen e gatishmërisë dhe përmirësimin e aftësive, për të operuar së bashku me aleatët në përmbushjen e objektivave taktike, operacionale dhe strategjike. Të hartohen plane dhe të punohet njëherazi në të gjithë elementët e saj si në: doktrina, strukturë, trajnim e stërvitje, pajisje e sisteme, procedura, komunikim, dhe infrastrukturë.

6.1. Standardizimi: Të jetësohet ky proces duke përzgjedhur, ratifikuar dhe implementuar STANAG/AP-të e Aleancës, të cilët mbështetin paketën e Objektivave të Kapaciteteve, prioritetet e FA dhe programet e modernizimit. Standardizimi të jetë në funksion të rritjes së ndërveprimit midis njëjësive dhe kapaciteteve të FA, për të marrë pjesë në operacione të drejtuara nga NATO, BE, OKB apo në koalicionet e tjera.

6.2. Stërvitja: Të rritet efektiviteti i stërvitjes për aftësimin e individëve, trupave dhe shtabeve, për kryerjen e operacioneve ushtarake dhe jo ushtarake, brenda e jashtë vendit. FA, me njësitë e deklaruara në NRF/VJTF, të marrin pjesë në stërvitjet e Aleancës, të cilat të shërbejnë edhe si platforma të vlerësimit, certifikimit dhe afirmimit të këtyre njëjësive. Të rritet përdorimi i simulimit në trajnim dhe stërvitje, të rishikohet plani i stërvitjeve kombëtare që do përfshihen në programin e Trajnimit dhe të Stërvitjes së NATO-s, të zgjerohet pjesëmarrja në stërvitjet rajonale dhe dypalëshe, si dhe stërvitjet e hapura për vendet rajonale. Të zhvillohen stërvitje ndër-institucionale për përbashkëpunimin e emergjencave civile dhe luftën kundër terrorizmit, me qëllim rritjen e kapaciteteve të FARSH, për



përmbushjen e detyrimeve në shërbim të qytetarëve dhe në mbështetje të autoriteteve civile, si dhe në kuadër të rolit të shtuar të FA.

6.3. Arsimimi të plotësojë nevojat e FA për burime njerëzore të afta dhe kompetente, në të gjitha nivelet, specialitetet dhe kategoritë e personelit duke shfrytëzuar mundësitë e FA dhe ato bilaterale. Të vijojë rishikimi dhe përmirësimi i programeve e planeve mësimore dhe të modernizohet procesi mësimor duke aplikuar metodologjitë bashkëkohore në mësimdhënie. Të intensifikohet mësimi i gjuhës angleze, duke përfshirë në kurset e niveleve të larta të lidhshpimit edhe modulet në gjuhën angleze, njohuritë e së cilës të jenë esenciale për promovimin në gradë, kualifikimin dhe emërimin e personelit.

6.4. Doktrina: Të rishikohet doktrina ushtarake, doktrinat e forcave si dhe rregulloret e manualet për llojet e trupave, armët e shërbimit në FA. Zhvillimi i doktrinës të ketë objektiv përcaktim të rrugëve dhe mënyrave të përmbushjes së detyrave ushtarake duke lidhur bashkë teorinë, historinë e praktikën dhe duke nxitur iniciativën dhe mendimin krijues. Institucionet arsimore, sipas nevojave të FA, të zhvillojnë projekte kërkimore dhe studimore me vlera aplikative, në aspektet teorike të artit dhe shkencës ushtarake, vlerësime dhe analiza për çështjet e sigurisë e mbrojtjes, apo plane në funksion të zhvillimit të kapaciteteve.

7. Pjesëmarrja në misione dhe operacione: FARSH të mbajnë në gatishmëri kapacitetet për pjesëmarrje sipas situatave, në operacione brenda vendit përfshi edhe mbështetjen e popullsisë dhe autoriteteve civile. FARSH të jenë të gatshme të përmbushin cilësisht angazhimet për kontribute në kuadër të mbrojtjes kolektive (RAP/NRF/VJTF) dhe të materializojnë të gjitha kontributet e deklaruara për operacionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB. (RSM, Afganistan, KFOR- Kosovë, ALTHEA -BiH, EUTM Mali dhe Irak). Të sigurohet që personeli ushtarak, që do të dislokohet në operacione të trajnimit, stërvitjen dhe pajisjen për kryerjen me profesionalizëm të detyrave sipas specifikave dhe kërkesave të operacionit.

8. Bashkëpunimi ushtarak: Bashkëpunimi ushtarak, i harmonizuar me

objektivat e politikës së jashtme të RSH, të jetë prioritet i FA, në funksion të përmbushjes së detyrimeve si vend i NATO-s, zhvillimit të kapaciteteve të mbrojtjes, bashkëpunimit për siguri në rajonale, si dhe thellimit të besimit, mirëkuptimit dhe intensifikimit të dialogut. FARSH të angazhohen maksimalisht për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të Enhanced NATO Response Force dhe iniciativave të Smart Defence Connected Forces Initiatives, si dhe Framework Nations Concept. Në bashkëpunimin ushtarak me BE, FA



të fokusohen në zbatimin e detyrimeve që lidhen me Politikën Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Bashkëpunimi ushtarak dypalësh, të bazohet në marrëveshjet dhe planet përkatëse si dhe në mirëkuptimin reciprok të fokusuar në bashkëpunimin e ngushtë me partnerin strategjik SHBA, me vendet Aleate dhe ato të rajonit, kryesisht në fushat e modernizimit, edukimit, trajnimit dhe stërvitjeve të përbashkëta. Bashkëpunimi ushtarak rajonal të përqendrohet në angazhimin aktiv dhe përfaqësimin cilësor në iniciativat rajonale, si Karta e Adriatikut, SEDM, RACVIAC, SEESAC. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet bashkëpunimit ushtarak me Kosovën.

9. Legjislacioni: Të vijojë hartimi, nxjerrja dhe rishikimi i të gjitha akteve të nevojshëm nënligjore në zbatim të akteve ligjore të miratuara, duke garantuar zbatimin e plotë të tyre. Të ndiqen detyrimet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, për përaftrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

10. Burimet e Mbrojtjes: Planifikimi kombëtar i mbrojtjes të harmonizohet me atë të NATO-s (NDPP) duke

bahen sipas kërkesave të gatishmërisë gjatë gjithë ciklit jetësor. Të vijojë programi për modernizimin e teknikës së transportit të FA.

Të sigurohet mbështetja me shërbime për personelin e dislokuar dhe të sigurohet transporti strategjik për forcat që do të dislokohen jashtë vendit. Të vijojë standardizimi dhe kodifikimi i materialeve për unifikimin e gjuhës dhe arrijtjen e ndërveprueshmërisë. Të zhvillohen kapacitetet e mbështetjes shëndetësore duke ri-konsideruar strukturën dhe organizimin e shërbimit, për ruajtjen e shëndetit të personelit Të hartohen planet e veprimit për demontimin/tjetërsimin e sasive të reja të municioneve të tepërta dhe jashtë nevojave dhe për trajtimin/eliminimin e materialeve të tepërta.

10.3. Menaxhimi Financiar: Burimet Financiare të FA, të sigurojnë mbështetjen e balancuar midis artikujve buxhetorë, me synim rritjen e nivelit të shpenzimeve kapitale për modernizim e infrastrukturë, duke mbështetur njëkohësisht prioritetet e përcaktuara në SU. Objektivat e kapaciteteve, të përfshihen në listën e integruar të prioritetëve edhe në programet e mbrojtjes dhe të shtrihen në kohë buxhetimi i tyre. Të vlerësohen dhe shfrytëzohen mundësitë për financim të projekteve nga donatorët. Të rritet efektiviteti i përdorimit të burimeve financiare nëpërmjet shfrytëzimit të sistemit të menaxhimit të burimeve të mbrojtjes, ndërsa efienca në menaxhimin e buxhetit, të arrihet duke rishikuar prioritetet dhe sipas tyre të hartohen në kohë projektet për të realizuar programimin.

10.4. Infrastruktura: Të investohet për të përmirësuar kushtet e jetës, punës dhe stërvitjes së personelit si dhe infrastrukturën e rajoneve stërvitore. Të vijojë trajtimi i pronave jashtë Planit të Përhapjes dhe Vendosjes nëpërmjet privatizimit, qiradhënies, transferimit, si dhe aplikimi për certifikatë pronësie të çdo prone në administrim të MM.

11. Përkujdesja: Fokusi të jetë në kapacitetet njerëzore, duke siguruar profesionalizmin, shanse të barabarta si dhe motivimin e ushtarakëve, për t'u ndjerë dinjitozë përkrah Aleatëve. Kjo të arrihet, duke planifikuar nevojat, vlerësimin real të performancës, trajtimin, mbështetjen dhe përkujdesjen e vazhdueshme për ushtarakët, gjatë gjithë ciklit jetësor. Të shqyrtohen mundësitë për mbështetjen e personelit civil me kredi të buta për strehim. Pagesat, kompensimi, strehimi dhe përkujdesja shëndetësore për personelin ushtarak aktiv dhe rezervë, të bëhet sipas akteve ligjore e nënligjore duke synuar përmirësimin e tyre. Kujdes të tregohet ndaj familjeve të ushtarakëve që dërgohen në operacione jashtë vendit. Perspektiva gjinore të shihet si pjesë integrale e politikave dhe planeve të Ministrisë së Mbrojtjes.

IV. PËRFUNDIME: Në zbatim të kësaj direktive, kërkoj nga Shtabi i Përgjithshëm, Komandantët e Forcave dhe ato Mbështetëse, Drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe strukturat vartëse të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, të hartojnë plane e programe konkrete veprimi në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kjo direktivë, si dhe të marrin të gjitha masat për realizimin në kohë e me cilësi të tyre.

Ministrja Kodheli priti komandantin e Qendrës së Bashkuar Operacionale Ajrore të NATO-s



Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, priti në një takim, komandantin e Qendrës së Bashkuar Operacionale Ajrore të NATO-s, CAOC Torrejon, Spanjë, gjenealmajor Ruben C. Garcia Servert. Një nga çështjet e rëndësishme ku u fokusua diskutimi ishte patrullimi i hapësirës ajrore të Shqipërisë nga NATO, e cila menaxhohet dhe kontrollohet nga CAOC Torrejon. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli falenderoi gjenealmajor Servert për kryerjen e këtij misioni me sukses dhe profesionalizëm. Angazhimet dhe kontributi i vendit tonë me personel në strukturën Komanduese të NATO-s, e cila tashmë ka arritur 95% të plotësisht, ishte një tjetër çështje që u diskutua gjatë këtij takimi. Në këtë kontekst, u theksua se në organizatën e Komandimit dhe Kontrollit Ajror të NATO-s, Forcat tona të Armatosura janë duke kontribuar me 3 oficerë, ku njëri prej tyre shërben pikërisht në qendrën e Torrejonit (CAOC Torrejon) dhe se, Shqipëria mbetet e gatshme të vijojë këtë nivel kontributi në mënyrë cilësore.

Ministrja Kodheli, duke trajtuar situatën aktuale të sigurisë e krijuar në kufijtë lindor dhe jugor të NATO-s, theksoi se mbetet

kritike që NATO të jetë vigjilente dhe e gatshme në tokë, det dhe ajër për t'iu përgjigjur rreziqeve dhe sfidave, nga çfardo drejtimi ato vijnë. CAOC Torrejon ka një mision shumë të rëndësishëm, pasi menaxhon dhe kontrollon hapësirën ajrore të Europës Jugore. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli u ndal edhe në implementimin e Planit të Gatishmërisë për Veprim (RAP), si një nga shtyllat kryesore të mbrojtjes kolektive. Në këtë kuadër, ajo theksoi se Shqipëria, siç është bërë e ditur, do të kontribuojë për periudhën 2016-2018 me një kompani në Forcën e Reagimit të Shpejtë të NATO-s (VJTF). Gjatë vitit 2016 Forcat tona të Armatosura do të jenë pjesë e Shtabit të Brigadës së kësaj force, e kryesuar nga Spanja.

Në lidhje me bashkëpunimin bilateral në fushën e mbrojtjes me palën spanjolle, znj. Kodheli nënvizoi se ky bashkëpunim është në një stad të kënaqshëm, por pritet të forcohet akomë edhe më tej, siç dhe ra dakord me homologun e saj spanjoll z. Eulate, gjatë vizitës së zyrtare që bëri në shtator në Spanjë.

Gjenealmajor Ruben C. Garcia Servert ishte për një vizitë zyrtare në vendin tonë, me ftesë të komandantit të Forcës Ajrore të FA, gjeneral brigade Vladimir Avdiqaj.

Mjeshtra amerikanë dhe specialistë shqiptarë përgatiten për përballimin e emergjencave të ndryshme detare

Mbyllet me sukses stërvitja "Delfini-2015"

SHEFQET KËRCELLI

Më datën 16 dhjetor në Qendrën e Simulimeve të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes u zhvillua faza finale e stërvitjes "Delfini-2015". Në këtë stërvitjen e drejtuar dhe organizuar nga Qendra Ndërinstitucionale Detare Operacionale (QNOD) dhe Qendra e Simulimeve, morën pjesë specialistë të institucioneve përbërëse të kësaj qendre, kordinatorë dhe specialistë nga Forca Detare, Policia Kufitare, Kapitenaria e Porteve, Antikontrabanda Detare, Forca Ajrore, Inspektoriati i Peshkimit, Inspektoriati i Mjedisit, Qendra Kombëtare e Emergjencave etj. Për mëse një javë pjesmarrësit, mbi bazë të skenarëve të parapregatitur për situatë të ndryshme në det, provuan aftësitë vendimarrëse e organizuese të tyre në lidhje me variantet e parashikuara si dhe përdorimin efikas të mjeteve në përdorim. Shefi i trajnimeve në QNOD, zoti Petrit Baduni dhe Kordinatori i FD në këtë Qendër, Kapiten i Rangut III Urim Bulica, sqaron se, e veçantë e kësaj stërvitje ishte se u planëzuan dhe realizuan variante taktike të operacioneve të kërkim-shpëtimit SAR, si dhe ato kundër trafikeve njerzore, të cilat përkojnë dhe me situatat aktuale rajonale, nga të cilat vendi ynë nuk është i përjashtuar. Me theks të veçante u pa bashkëveprimi midis të gjithë aktorëve shtetërorë që veprojnë në det gjatë këtyre operacioneve, dhënia në kohë optimale e ndihmës për personat në rrezik, përzgjedhja e mjetit më të përshtatshëm, monitorimi i situatave komplekse të krijuara nga këto emergjenca detare, kërkim-shpëtimi në përputhje me Manualin SAR, ndërveprimi dhe bashkëpunimi i të gjitha agjencive përgjegjëse për menaxhimin e këtyre situatave etj.

Gjithashtu në stërvitjen "Delfini-2015" vend të veçantë zunë situatat dhe operacionet për kontrollin e kufijve detarë, si ato për kalimin e paligjshëm të qenieve njerzore e refugjatëve gjatë kufirit detar, rastet kur në bordet e anijeve ka dhe persona të armatosur, por dhe rastin kur vetë anija pëson avari dhe e rëndon më tepër situatën detare. Në përputhje me situatat e dhëna nga kordinatorët e stërvitjes u përcaktuan dhe mjetet e Forcës Detare, të Policisë Kufitare, Antikontrabandës dhe Kapitanerisë, që u përdorën në cdo rast. Është stërvitja e



trëte që institucionet tona detare zhvillojnë në Qendrën e Simulimeve, një nga asetet më të mira të FA, që i ka dhënë frymëmarje të veçantë gjithë procesit stërvitor në ushtrinë tonë. Madje spektri i veprimeve të saj e ka zgjeruar shtrirjen deri në rajon, siç ishte stërvitja "Joint Reaction-2015". Major Lulëzim Salihi, një nga specialistët e Qendrës së Simulimeve që në krijimin e saj, theksoi se, "shohim që nga stërvitja "Pulëbardha-2014", "Adri-

2015" dhe deri tek "Delfini-2015" ka një përmirësim të procedurave dhe rritje të aftësive profesionale të personelit të këtyre institucioneve. Sigurisht në situatat që japim në monitorë përpiqemi t'i përafrohemi ngjarjeve reale në det. Gradualisht, Qendra e Simulimeve po familjarizohet me skenarë të tillë, anasjelltas dhe detarët shqiptarë ndjehen mirë gjatë ushtrimeve në kabinetet dhe sistemin dixhital të Qendrës. Stërvitjet në Qendrën tonë, dhuratë e Departamentit të

Shtetit të SHBA, kanë mjaft vlera në të gjitha aspektet stërvitorë". Me tej, duke renditur këto vlera, major Salihi vijon " Së pari shkurtohet koha e stërvitjes, ulët kostoja e saj disa herë, mënjanohet dëmtimi i mjedisit, zbatohet standartet e NATO-s për këto lloj stërvitje. Gjithashtu, si drejtuesit e operacioneve apo komandantët e anijeve dhe sikur të bëjnë gabime në vendimarrje, kanë mundësinë t'i korigojnë ato, pa shkakuar konsequenca në ecurinë e operacionit, siç mund të ndodhte në një situatë reale". Nën drejtimin e specialistëve amerikanë, ish-ushtarakë Tony Darlington e Dee Esplind, si dhe personelit të Qendrës së Simulimeve, u arrit që të realizohen objektivat e stërvitjes, ku bazë ishte përmirësimi i aftësive individuale dhe bashkëveprimi midis institucioneve tona ligjzbatuese në det, gjatë misionit dhe detyrave të tyre parësore. Në konkluzionet e stërvitjes pjesëmarrësit falenderuan personelin e Qendrës së Simulimeve dhe nxorën disa mësimet për t'i korigjuar në të ardhmen si, dhënie në kohë të situatave, saktësimin

e koordinatave të objekteve të ndryshme në det, futjen e shpejtësisë reale të cdo mjeti detar në Database, përmirësimin e legjislacionit e rregullore, të sistemeve të komunikimit, shkëmbimi i informacionit, përdorimi i helikoptereve për zbulim detar, përafrimi i punës nga ajo ç'ka bëjmë te Qendra e Simulimeve me zbatimin e detyrave funksionale në QNOD etj. Kapiten Besnik Deda e vlerësoi këtë stërvitje si një eksperiencë të re dhe me perspektivë në përgatitjen e personelit të institucioneve detare të shtetit shqiptar. Nuk është e paktë të përgatisësh dhjetëra kuadro e specialistë në përballimin e emergjencave të ndryshme detare, theksoi kapiteni. Ndërsa drejtori i Antikontrabandës Detare, zoti Ylli Hatellari, nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit midis institucioneve detare, verifikimin e saktë të situatave e objekteve dhe planifikimin e aseteve të duhura për cdo operacion.

"Delfini-2015" mbylli siparin e 13 stërvitjeve të zhvilluara në Qendrën e Simulimeve gjatë vitit 2015. Dhe ky është një bilanc që flet qartë për rolin dhe punën që bëhet në këtë institucion të rëndësishëm të Forcave tona të Armatosura.

Nxënës të shkollës së mesme "Ismail Qemali" vizitojnë anijen "Lissus"

Në zbatim të detyrës së Ministres së Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, për promovimin e aktivitetit të Forcës Detare dhe thithjen e kontigjentit të detarëve profesionistë, komanda dhe shtabi i Forcës Detare kanë hartuar një program të veçantë, ku përfshihen vizita në anije, takime e biseda me detarë të vjetër etj. Konkretisht, paraditen e datës 21 dhjetor 2015, pjesë e këtij promovimi ishin një grup maturantësh të shkollës së mesme "Ismail Qemali" në Tiranë. Fillimisht nxënësit e kësaj shkolle u pritën në molin "0" të portit të Durrësit nga zv/komandanti i FD, Kapiten i Rangut I Adnan Agastra dhe kuadro të anijeve "Iliria", "Lissus" dhe motovedetës heroinë të FD, R-118. Mbas urimit të mirëseardhjes, zoti Agastra i shpjegoi vizitorëve detyrat kryesore që kryejnë anijet tona në det, operacionet humanitare dhe ato për zbatimin e ligjshmërisë, çfarë përfaqëson profesioni i bukur i marinarit, anijet në përdorim të FD, që nga MV,R-118, anija "Iliria", "Lissus" deri tek anijet më të shpejta për luftën kundër trafikeve detare, "ARCHANGEL", dhuratë e Departamentit të Shtetit të SHBA. Më pas, maturantët e "Ismail



Qemalit" zhvilluan një lundrim në gjirin e Durrësit me anijen "Lissus" ku u njohën jo vetëm me bukuritë e gjirit të Durrësit, por panë dhe punën direkte të detarëve tanë nëpër poste luftarake. Zonja Aida Nova, nëndrejtoreshë e Shkollës "Ismail Qemali" u shpreh e entuziazmuar për këtë eksperiencë të bashkëpunimit mes shkollës dhe Forcës Detare. Ndërsa zonja Desara

Karaj, mësuese kujdestare, ndërkohë dhe studjuese e historisë, u interesua për traditën dhe historinë e detarisë së popullit shqiptar, të cilën e pa të zgjeruar tek libri "Antologji e Detarisë Shqiptare". Në vijim të lundrimit djemtë dhe vajzat maturantë, veç fotove të shumta në anije dhe detit të paanë, shprehën dëshirën që mbas studimeve të arsimohen në shkollat e detarisë brenda dhe jashtë vendit. Maturantët Ambra Shehu, Jurgen Lubonja, Amarildi Tomorri, etj, provuan uniformën dhe kapelen e marinarit në urën e komandimit të anijes. Duam të bëhemi kapitenë anijesh! thanë këta të rinj. Mirë, mirë, por më parë duhet të jesh marinar! tha dikush tjetër. Kështu për mëse tre orë, ky grup rinor provoi ndjesitë, ëndrrat dhe emocionet që të dhuron zanati i detarit.

Në jemi popull detar dhe me këto aktivitete zgjojmë ëndrrën dhe dëshirën të rinjtë tanë që të kualifikohen e trajnohen për tu bërë pjesë e Flotës sonë Tregëtare ose Luftarake. Kështu, tradita e detarisë shqiptare do vazhdojë në shekuj. Ky ishte dhe mesazhi i këtij aktiviteti mbresëlënës.

Shefqet Kërçelli

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA priti komandantin e CAOC të NATO-s



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, priti komandantin e Qendrës së Përbashkët të Operacioneve Ajrore (CAOC) të NATO-s, gjeneralmajor Rubén C. Garcia Servert. Qendra e Përbashkët e Operacioneve Ajrore (CAOC) të NATO, që ndodhet në Bazën Ajrore të NATO në Torrejon, Spanjë, ka si mision mbajtjen nën vëzhgim të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë, si pjesë e Policimit Ajror që NATO kryen për vendet anëtare të saj. Qëllimi i vizitës së gjeneralmajor Servert në vendin tonë ishte njohja nga afër të kapaciteteve të Shqipërisë, si dhe për të diskutuar me drejtuesit më të lartë të Ministrisë së

Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe Komandës së Forcës Ajrore për kryerjen sa më të mirë të misionit të vëzhgimit të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë takimit, gjeneralmajor Bazo shprehu konsideratat më të larta për bashkëpunimin me Qendrën e Përbashkët të Operacioneve Ajrore të NATO, në drejtim të vëzhgimit dhe ruajtjes së hapësirës ajrore të Shqipërisë, por edhe në drejtim të trajnimit të stafit dhe asistencës për Qendrën e Raportimit dhe Kontrollit të FARSH. Ndërsa gjeneralmajor Servert shprehu gatishmërinë për vijimin e mëtejshëm dhe rritjen e këtij bashkëpunimi dypalësh në kuadër të NATO-s.

Në Komandën e Forcës Detare është zhvilluar një veprimtari me rastin e 90-vjetorit të krijimit të Flotës sonë Ushtarake Detare. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, komandantët e Forcave, gjeneralë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, ish-drejtuës dhe ushtarakë veteranë që kanë shërbyer ndër vite në strukturat e Forcës Detare, si dhe mjaftë të ftuar të tjerë.

Pas fjalës së rastit që mbajti komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ylber Dogjani, të pranishmit i përshëndeti ministrja e Mbrojtjes Kodheli, e cila uroi detarët shqiptarë në këtë jubile të 90-vjetorit të krijimit të Forcës Detare. "Qysh në fillim dua të shpreh mirënjohjen e thellë për punën, përkushtimin dhe vetëmohimin që gjeneratat e detarëve ushtarakë kanë treguar ndër vite, duke dëshmuar se kanë qenë të gatshëm edhe për sakrificën sublime, në përmbushje të misionit dhe detyrave, sfidave dhe të papriturave.", - është shprehur ministrja Kodheli.

Duke u ndalur në rrugëtimin gati një shekullor të Forcës sonë Detare, ministrja Kodheli nënvizoi se, mbas viteve 90, me mbështetjen e partnerëve tanë të NATO-s, veçanërisht SHBA, Forca Detare ka bërë hapa para duke zhvilluar kapacitete efektive në përmbushje të misionit kushtetues, zbatimit të ligjshmërisë detare dhe detyrave. Kontrolli i hapësirës detare sot realizohet nëpërmjet Sistemit të Ri të Vëzhgimit të saj dhe janë krijuar kapacitetet e nevojshme për kryerjen e operacioneve në rastet e emergjencave civile në ndihmë të komunitetit. Duke qenë përherë prezent dhe aktivë në det, Forca Detare është bërë një aktor i rëndësishëm dhe i vlerësuar nga opinioni publik, shteti shqiptar dhe partneret", - theksoi ajo.

Në fund të fjalës së saj ministrja e Mbrojtjes Kodheli ka shprehur mbështetjen e saj për modernizimin e mëtejshëm të Forcës Detare dhe për përgatitjen e trajnimit e detarëve shqiptarë, të cilëve, gjithashtu, i përgëzoi dhe i uroi gëzuar festat e fundvitit, Krishtlindjet dhe Vitin e Ri 2016.

Forca jonë Detare ka një histori të lavdishme në shërbim të atdheut. Përpyekja e parë për organizimin e një shërbimi të marines ushtarake është 25 dhjetori i vitit 1925, kur Parlamenti i Shqipërisë miratoi buxhetin për blerjen e dy anijeve ushtarake nga Italia "Shqipnia" dhe "Skënderbeg". Me riorganizimin e ushtrisë shqiptare, më 24 qershor 1928 u krijua Komanda e Marinës Mbretërore në Durrës. Në vitin 1926 u blenë dhe erdhën nga Italia katër motovedetat e para. Por çlirimi i Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë e gjeti vendin plotësisht të shkatërruar dhe po ashtu edhe Marinën Luftarake. Në shkurt 1945, kur Kapiteni i Parë Abdi Mati u titullua oficer marine i ushtrisë shqiptare, detyra e parë që mori ishte riorganizimi i Marinës Luftarake. Më 15 gusht 1945, me krijimin e Seksionit të Marinës, nisi edhe riorganizimi Marinës Luftarake Shqiptare, e cila nga viti në vit erdhi duke u forcuar dhe modernizuar me anije dhe mjete të shumta luftarake detare. Pas viteve '90, ashtu si të gjithë Forcat tona të Armatosura, edhe Forca Detare është reformuar në përshtatje me kushtet e reja dhe çdo ditë e më shumë po forcohet e modernizohet sipas standardeve të NATO-s për të kryer me nder misionin e saj kushtetues.

Kremtohet 90-vjetori i krijimit të Forcës Detare

PËRSHËNDETJA E MINISTRES SË MBROJTJES MIMI KODHELI ME RASTIN E 90-VJETORIT TË KRIJIMIT TË FORCËS DETARE

*Të nderuar veteranë të Flotës, komandantë e detarë!
Të nderuar të ftuar.*

Është nder dhe kënaqësi për mua të uroj detarët shqiptarë në këtë jubile të 90 vjetorit të krijimit të Forcës sonë Detare. Vendi ynë ka një traditë të spikatur të detarisë, përgjatë gjithë historisë shekullore, ku në çdo periudhë, epokë apo ngjarje historike, detarët shqiptarë kanë qenë gjithmonë prezent në Adriatik e Jon.

Në këtë rrugëtim shekullor, kontributit të brezave të detarëve i shtohet edhe roli i pazëvendësueshëm i detarëve me uniformë, të cilët kanë shkruar historinë e tyre, si pjesë integrale e historisë së Popullit Shqiptar, me sakrificë, vështirësi, guxim e heroizëm, duke u përballur me dallgët e detit, lundrime pa fund, ditë e natë, në mot të qetë e të trazuar.

Sot ne nderojmë dhe respektojmë aktin historik të ekuipazheve të anijeve "Shqiponja" dhe "Skënderbeg", të cilët më 25 dhjetor 1925, pas përvojës si detarë, filluan patrullimin për ruajtjen e kufirit detar të shtetit shqiptar. Në shtypin e asaj kohe shkruhej se dy anijet e bregëzuara në Currila u përshëndetën nga qytetarët e Durrësit dhe pasi u larguan një milje nga bregu, bënë tre të shtëna me artileri.

Nga ajo ditë e shënuar, Flota jonë Luftarake sikurse gjithë Forca e Armatosur, ka njohur transformime dhe zhvillime të rëndësishme, me ulje-ngritjet e saj.

Qysh në fillim dua të shpreh mirënjohjen e thellë për punën, përkushtimin dhe vetëmohimin që gjeneratat e detarëve ushtarakë kanë treguar ndër vite, duke dëshmuar se kanë qenë të gatshëm edhe për sakrificën sublime, në përmbushje të misionit dhe detyrave, sfidave dhe të papriturave. Po ashtu, dua të përmend në mënyrë specifike mirënjohjen për ekuipazhet e anijeve që ndër vite kanë zhvilluar operacione emergjencash, kërkim-shpëtimi dhe operacione humanitare pikërisht në ato kushte moti kur askush tjetër nuk guxon ti afrohet as bregut.

Mbas viteve 90, me mbështetjen e partnerëve tanë të NATO-s, veçanërisht SHBA, Forca Detare ka bërë hapa para duke zhvilluar kapacitete efektive në përmbushje të misionit kushtetues dhe zbatimit të ligjshmërisë detare. Kontrolli i hapësirës detare sot realizohet nëpërmjet Sistemit të Ri të Vëzhgimit të saj. Janë krijuar kapacitetet e nevojshme për kryerjen e operacioneve në rastet e emergjencave civile në ndihmë të komunitetit. Duke qenë përherë prezent dhe aktivë në det, Forca Detare është bërë një aktor i rëndësishëm dhe i vlerësuar nga opinioni publik, shteti shqiptar dhe partnerët.

Anëtarësimi në NATO ka qenë një moment kritik pasi shtroi nevojën e reformimit të Forcës Detare, përmirësimi të legjislativitetit detar, konsolidimin e strukturave dhe modernizimin e saj. Me një plan racional modernizimi dhe transformimi, mbështetur në mundësitë e vendit tonë, janë hedhur hapa të konsoliduar në modernizimin e FD me sisteme, pajisje e mjete detare,

sipas prioriteteve. Sot FD është kompletuar me mjetet e reja që i nevojiten për të përmbushur misionin e Rojës Bregdetare, pas pajisjes me katër anije patrulluese të mëdha; me Motovedeta të shpejta dhe anije antindotje.

Po ashtu, ndërtimi i Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare, pajisja e anijeve të Rojës Bregdetare me sisteme të vëzhgimit natën, përmirësimet infrastrukturore të vendbazimeve detare, etj. janë hapa konkretë në zbatim të politikave për zhvillimin e Forcës Detare.

Forca Detare ka pasur bashkëpunim të frytshëm dhe projekte të rëndësishme me Komandën e Komponentit Detar të NATO-s në Napoli dhe Northwood, Angli, me Flotën e 6-të të SHBA në Mesdhe, si dhe me Flotat partnere të vendeve Aleate, duke rritur aftësitë dhe kapacitetet operacionale.

Në këto vite FD ka përmbushur me sukses misionin dhe detyrat dhe ky përvjetor i 90-të i gjen ato më të afta, më të pjekura dhe të zhvilluara, me personel të motivuar e të aftë profesionalisht, me mjete të reja dhe infrastrukturë moderne. Rritja e ndërveprueshmërisë me flotat e vendeve të NATO-s e do të vijojë të ngelet sfidë edhe pse gjatë stërvitjeve të përbashkëta të viteve të fundit, efektivat tona kanë dëshmuar se janë jo vetëm të aftë por dinjitozë dhe të barabartë.

Unë besoj fort se Forcat Detare do të vijojnë të jenë të gatshme për operacione, aksione e prezencë për patrullimin, ruajtjen dhe kontrollin e hapësirës sonë detare dhe sigurimin e

ligjshmërisë në det, sikurse edhe për të mbështetur popullsinë dhe autoritetet civile në rastet e emergjencave dhe fatkeqësive. Po ashtu sfidat e të ardhmes kërkojnë vizion, objektiva e synime të qarta, një përqasje gjithëpërfshirëse dhe efektivitet në listimin e prioriteteve, planifikim dhe programim.

Të nderuar pjesëmarrës!

Forcat Detare, në këto 90 vite kanë pasur zhvillime të rëndësishme ku efektivat e saj janë dalluar për profesionalizmin, kulturën, vullnetin e përkushtimin në kryerjen e misionit fisnik për mbrojtjen e kufijve dhe zbatimin e ligjshmërisë detare. Detarët tanë e kanë shkruar me mund, djersë, gjak e sakrificë të panumërta, historinë e Forcës Detare Shqiptare. Mirënjohja për mundin dhe sakrificat nuk harrohen por do përcillen me respekt në gjeneratat e ardhshme.

Sikurse e theksova, anëtarësimi në NATO, krahas përfitimeve për sigurinë e vendit tonë, shtron edhe nevojën për personel, pajisje e procedura të ndërveprueshme me aleatët. Me këtë rast desha të shprehja mbështetjen time, e cila në asnjë rast nuk do të mungojë, jo vetëm për modernizimin por edhe për zhvillimin e personelit, trajnimin e stërvitjen, duke shfrytëzuar me efektivitet burimet tona, por edhe mundësitë e ofruara në kuadrin bilateral ku FD ka qenë shumë e suksesshme.

Është gjë e bukur që festa e detarëve përkon dhe me festat e fundvitit, ndaj gjej rastin t'ju uroj:

*Gëzuar Krishtlindjet dhe Festën e Vitit të Ri 2016!
Suksese të mëtejshme, shëndet e mbarësi në familjet tuaja!*



Me rastin e 90-vjetorit të krijimit të Flotës Ushtarake Detare Forca Detare Shqiptare, një histori e lavdishme në shërbim të atdheut



Kapiten i Rangut të Parë
ARTUR MEÇOLLARI
Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të
Përgjithshëm dhe Antikorrupsionit

Shqipëria është një vend bregdetar me tradita të herëshme detarie. Historia e detarisë shqiptare është po aq e lashtë sa edhe vetë kombi shqiptar, por në këtë shkrim që po publikojmë në ditën 90-vjetorit të krijimit të Forcës sonë Detare, do të ndalemi në disa nga periudhat më të qënësishme të ngritjes dhe zhvillimit të saj.

Nga Pavarësia deri në Luftën e Dytë Botërore

Mbas shpalljes së Pavarësisë dhe krijimit të qeverisë së parë me në krye patriotin dhe plakun e urtë Ismail Qemali, më 28 nëntor 1912, në përbërje të kësaj trupe bënte pjesë edhe dikasteri i rëndësishëm i Luftës (i Mbrojtjes Kombëtare) me në krye një gjeneral karriere dhe komandant i shquar i kryengritjeve shqiptare të viteve 1911-1912, Mehmet Pashë Dërralla (Tetova). Ndërsa i Shtabi Madhor u formua më 4 maj 1913, me miratimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe kryetari i këtij Shtabi u emërua major Ali Shefqeti (Shkupi). Gjatë qeverisjes së Ismail Qemalit në pak më shumë se një vit, por edhe në vitet që pasuan shteti i ri shqiptar nuk arriti të ngrinte marinën e tij ushtarake.

Më 5 mars 1914 është dita kur një anije luftarake nge flamurin e Shqipërisë në Trieste. Kjo ishte anija ushtarake austro-hungarezë "Taurus", e cila morri në bord Princin Ëillian de Èied (Princ Vidin), mbretin e Shqipërisë, për udhëtimin drejt Durrësit. Gjatë mbretërisë së Princ Vidit Shqipëria mori me qera avulloren tregëtare austro-hungarezë "Herzegovina", të cilës më pas iu

KOMANDANTËT E FORCËS DETARE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1926-1939 - Marina Mbretërore
1926-1930 Kapiten i Rangut të Tretë Giuseppe Prelli
1931-1939 Kapitenit të Rangut të Tretë Silvio Montanarella

1939-1945 - Lufta e Dytë Botërore
1945-1957 - Sheksionii Marinës
1945-1957 - Kapiteni i Parë Abdi Mati

1957-1993 - Flota Luftarake Detare
1957-1959 - Kundëradmiral Teme Seiko
1959-1960 - Kundëradmiral Abdi Mati
1960-1961 - Kundëradmiral Hiti Çako
1961-1974 - Kundëradmiral Abdi Mati
1974-1981 - Zoti Qamil Poda^(a)
1981-1991 - Zoti Ndue Jaku^(a)
1991-1992 - Kapiteni i Rangut të Parë Tasim Meçe
1992-1993 - Kapiteni i Rangut të Parë Fitim Halili

1993 - 1998 - Forcat e Mbrojtjes Detare
1993-1994 - Kapiteni i Rangut të Parë Edmond Zhupani
1994-1996 - Kundëradmiral Muharrem Kuçana
1996-1997 (3) - Kundëradmiral Edmond Zhupani
1997 (3) - 1997 (9) - Kapiteni i Rangut të Parë Vladimir Beja
1997 (9) - 1998 (11) - Kapiteni i Rangut të Parë Robert Bali

1998 - Forcat Detare (2002 edhe Rupa Bregdetare)
1998 (11) - 2005 (1) - Kundëradmiral Kudret Çelaj
2005 (4) - 2009 (9) - Kapiteni i Rangut të Parë Kristaq Gerverni
2009 (9) - 2012 (1) - Kundëradmiral Kudret Çelaj
2012 (8) - 2015 (4) - General Brigadë Qemal Shkurti
2015 (10) - General Brigadë Ylber Dogjani

(a) - Nga viti 1967-1990 është e periudha e heqjes së gradave në Forcat e Armatosura

vendos një top dhe kjo është anija e parë ushtarake e përdorur për veprime luftarake.

Përpjekja e parë për organizimin e një shërbimi të marines ushtarake është 25 dhjetor 1925, kur Parlamenti i Shqipërisë miratoi buxhetin për blerjen e dy anijeve ushtarake nga Italia "Shqipnia" dhe "Skënderbeg", të cilat mbërritën në Shqipëri në vjeshtën e vitit 1926. Me riorganizimin e ushtrisë shqiptare në vitin 1928, dhe pikërisht më 24 qershor 1928 u krijua Komanda e Marinës Mbretërore në Durrës. Në vitin 1926 u blenë dhe erdhën nga Italia katër motovedetat, "Tirana", "Saranda", "Durrësi" dhe "Vlora" dhe në vitin 1938 mbërriti në Shqipëri edhe jahti mbretëror "Iliria". Në këtë

kohë personeli i Marinës Mbretërore ishte rreth 100 vetë dhe midis viteve 1925 deri në vitin 1939 komandantët e Marinës Mbretërore të Shqipërisë kanë qënë dy oficerë detar italian, të cilët organizuan këtë armë.

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia, Marina Mbretërore Shqiptare pushoi së ekzistuari. Italisë dhe anijet e saj u përdorën nga forcat ushtarake italiane. Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore pjesa më e madhe e anijeve ishin mbytur dhe ndonjë prej tyre gjendej në Itali. Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore e gjeti Shqipërinë pa anije dhe pa strukturë të marinës luftarake.

Gjatë Luftës së Ftohtë

Clirimi i Shqipërisë, më 29 nën-

tor 1944, e gjeti vendin plotësisht të shkatërruar dhe po ashtu edhe Marinën Luftarake. Në shkurt 1945, kur Kapiteni i Parë Abdi Mati u titullua oficer marine i ushtrisë shqiptare, detyra e parë që mori ishte riorganizimi i Marinës Luftarake. Nga koha e luftës, në portet shqiptare kishin ngelur të mbytura dy motovedeta të Marinës Mbretërore të Klasit ELCO, të cilat u nxorën, u riparuan dhe u vunë në gadishmëri. Më 15 gusht 1945 këto motovedeta, si edhe motovedeta "Mujo Ulqinaku", u rifutën në shërbim të Seksionit të Marinës, datë e cila shënon riorganizimin e Marinës Luftarake Shqiptare. Në vitin 1954 erdhi nga ish-Bashkimi Sovjetik skuadrilia e parë e katrave silurues



e cila u pasua në vitin 1957 dhe 1958 me pajisjen e Flotës Luftarake Detare me nëndetëse, dragamina, gjuajtësa kundërnëndetëse, anije polumbare dhe një numër anije ndihmuese. Mbas vitit 1957 Flota Luftarake Detare zotëronte kapacitete luftarake të krahasueshme me fqinjët tanë detare. Në vitet 1957-1958 Flota Luftarake Detare nën drejtimin e Kapitenit të Rangut të Parë Abdi Mati në bashkëpunim me Forcat Detare Greke organizoj një nga operacionet me të vështira, atë të pastrimit të Kanalit të Korfuzit, i cili nuk kishte qënë i lirë për lundim për gati 10 vjet.

Në këto vite Baza e Pashalimanit u shndërrua në bazë të Traktatit të Varshavës, ku u bazuan 12 nëndetëse të mesme taktike të klasit "Ëiskey 5", si dhe shumë anije të tjera. Vitet 1957-1961 kanë qënë vite të vështira për drejtimin e Flotës Luftarake Detare. Nga viti 1945 deri në vitin 1957 komandant i Seksionit të Marinës ka qënë Kapiteni i Rangut të Parë Abdi Mati, një oficer detar me përvojë dhe i arsimuar në Akadmiën Detare të Livornos, Itali. Mbas vitit 1957 në krye të Flotës u vendos një oficer artilier me profil politik, gjeneralmajor Teme Seiko dhe pas tij gjeneralmajor Hito Çako. Në këtë periudhë barra e Flotës i ra përsëri kundëradmiral Abdi Matit, i cili brenda disa muajsh u emërua nga zëvendëskomandant i Flotës, komandant i Brigadës së Nën-detëseve dhe më pas përsëri Komandant i Flotës Luftarake.

Viti 1961 shënon vitin kur Flota Luftarake u kthye në identitetin e saj profesional. Komandant i Flotës u riemërua për herë të tretë kundëradmirali Abdi Mati, post që do ta mbante për 12 vjet, deri në vitin 1973. Gjatë kësaj periudhe Flota Luftarake u përgatit dhe niveli profesional pati një hop cilësor për përdorimin e teknikës moderne për kohën. Në vitet 1974 Flota do të pajisej përsëri me mjete detare tashmë të ardhura nga Kina. Fuqia luftarake e Flotës Detare kishte arritur në nivelet më të larta, po kështu dhe profesionalizmi i personelit të saj. Me prishjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik Flota Luftarake krijoi Akademia e saj të Marinës, në



vitin 1961. Prishja e marrëdhënieve me BS dha pasoja politike dhe ekonomike, por mbi të gjitha krijoi një tension, sidomos në Bazën Detare të Pashalimanit. Ngjarjet e vitit 1960-61 në këtë bazë ushtarake ishin treguesi i tensionit midis dy vendeve. Oficerët, nënoficerët dhe detarët e Flotës Luftarake Detare treguan një heroizëm të jashtëzakonshëm, që shkruantari ynë i shquar Ismail Kadare i ka pasqyruar në romani e tij “Dimri i Vetmisë së Madhe” dhe Piro Milkani e Kujtim Çashku në filmin “Ballë për ballë”. Simbolika e Nëndetësës 105 është heroizmi dhe patriotizimi i treguar nga efektivat e Flotës Luftarake në këtë konflikt të ftohtë.

Abdi Mati, drejtuesi vizionar i Flotës Ushtarake Detare

Konsolidimi i Flotës Luftarake Detare është padyshim merita e kundëradmiral Abdi Matit dhe pesonelit të saj. Në këtë periudhë u krijua Kantieri i Riparimit të Anijeve (1967), Shërbimi Hidrografik (1968), Baza e Durrësit (1967), Shëngjinit (1967), Sarandës (1967) dhe më pas e Palermos (1987). Pas daljes në lirim të kundëradmiral Matit drejtimin e Flotës Luftarake Detare e mori një brez oficerësh dhe komandantësh, të cilët do të ruanin me besnikëri trashëgiminë që kundëradmirali kishte lënë. Komandantët e ardhshëm të Flotës Qamil Poda dhe Ndue Jaku, do të drejtonin Flotën me profesionalizëm dhe integritet sa edhe kundëradmiral Mati. Po kështu në memorien historike të Flotës janë gdhëndur oficerë drejtues të shquar si: Mark Plani, Azis Hasa, Xhemal Shani, Shefqet Pinari, Aleko Pojani, Dashamir Oheri, Petrit Myftiu, Tasim Meçe, Zisi Anastasi, Muharrem Kuçana, Beqir Gërbi etj. dhe një brez i tërë oficerësh të edukuar në Akademinë e Detarisë në Vlorë si: Fitim Halili, Çapajev Smotkthina, Robert Bali, Piro Kuçi, Vladimit Beja, Çapajev File, Ylli Lika, Nikola Tole, Bilbil Aliaj, Kudret Çela, Petrit Baduni, Mithat Islami, Bashkim Kryeziu etj. Por, padyshim, Kundëradmiral Mati është strategu ushtarak, i cili projektoi fuqinë detare të Shqipërisë. Ai në

shkurt të vitit 1945, kur u titullua oficeri me i lartë i Marinës, nuk kishte në dispozicion asnjë mjet lundrues. Në 30 vite që shërbeu në Flotën Luftarake kundëradmiral Mati për 25 vjet ishte komandant i saj. Kur ai doli në pension, në vitin 1975, Flota Luftarake kishte mbi 100 anije, ndër të cilat

Detare.

Drejt perëndimit

Ndryshimet politike të viteve 90’ sollën nevojën e ndryshimeve në Forcën Detare. Pas anëtarësimit të Shqipërisë në iniciativën e “Partneritetit për Paqe”, Forca Detare filloi



katër nëndetëse, 10 gjuajtësa detarë mi 40 karta silurues, tetë minahqëse, polumbare dhe një numër anijesh ndihmuese. Flota Luftarake Shqiptare në këtë periudhë edhe pse operonte e izoluar, nuk ishte e neglizhueshme nga fqinjët tanë detarë, por përkundrazi e krahasueshme dhe e vlerësuar. Tek kundëradmiral Abdi Mati ishin të ndërthurura personaliteti i një ushtaraku profesionist dhe të përkushtuar, drejtuesi vizionar dhe me autoritet, njeriut të dashur dhe të respektuar nga të gjithë. Kundëradmiral Abdi Mati me trashëgiminë e tij përfaqësonë vlerat më të mira të një ushtaraku dhe detari, për të cilat brezat do të kenë nevojë. Kundëradmiral Abdi Mati është padiskutim ushtaraku dhe detari model për çdo oficerë, nënoficer dhe detar të Forcës Detare. Ai është vetë trashëgimia që vazhdon të frymëzoj ende personelin e Forcës

vitjet e para të përbashkëta me Forcat Detare të SHBA, “SAREX-I” dhe “SAREX-2” dhe Forcat Detare Turke, “MAREX-I” dhe “MAREX-2”. Në këtë periudhë Forcat tona Detare realizojnë angazhimin e tyre të parë për sigurinë rajonale detare, duke mbështetur koalicionin ndërkombëtar të embargos kundër Jugosllavisë.

Viti 1997 solli dëme të jashtëzakonshme në Forcat tona Detare. Midis viteve 1997-2000 u bë një punë e jashtëzakonshme për ringritjen dhe funksionimin e Distriktit Detar të Vlorës dhe Durrësit, si dhe Bazat Ndihmuese Sarandë e Shëngjin. Një ndihmë shumë të madhe në këtë proces dhanë vendet anëtare të NATO-s si: SHBA, Italia, Turqia, Greqia, Gjermania etj. Në mars të vitit 1998 me ndihmën e qeverisë së SHBA, Forca Detare u pajis me 5 motovedeta, të cilat u bënë protagonistë të operacioneve SAR në vitet e ardhshme. Po ashtu SHBA i dhuron FD 5 motovedeta të tjera në vitin 2012, ndërsa në vitin 2002 dhe 2004 qeveria e Italisë dhuroi 12 motovedeta të tjera. Në këtë periudhë procesi i riorganizimit të Forcës Detare solli nxjerrjen nga armatimi të një numri anijesh tashmë të amortizuara. Mbas vitit 2002, Forca Detare u ngarkua me një mision tjetër të rëndësishëm: atë të Rojës Bregdetare. Qysh në fillim u krijua baza e plotë ligjore e Rojës Bregdetare, si dhe u vendosen marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligj-zbatuese. Rezultat i këtij bashkëpunimi ishte Operacioni “PUNA” në vitin 2003, në të cilin morën pjesë strukturat e Forcës Detare, si dhe 14 mjete detare.

Mbas vitit 2004, Forca Detare hyri në një fazë të re zhvillimi, i cili mundësoi organizimin për herë të parë në Shqipëri të një stërvitje detare të NATO-s, “Cooperative Engagement 05” në shtator 2005. Anije të Forcës Detare për herë të parë në vitin 2005, morën pjesë në një stërvitje rajonale në Itali, dhe më pas në Greqi, Kroaci, etj.

Bashkëpunimi për sigurinë rajonale i Forcës Detare është një angazhim aktiv në disa iniciativa dhe

operacione si: V-RMTC, ADRION, SAR, MEDITERANIAN DIALOG dhe më e rëndësishmja pjesemarrje në Operacionin e NATO-s “Active Endeavour” qysh prej vitit 2008. Forca Detare tashmë ka hyrë në procesin e saj të modernizimit, fillimish me ndërtimin e Sistemit të Integruar të Vezhgimit të Hapësirës Detare dhe prodhimit të anijeve të reja të Projektit STAN PATROL 4207 në Kantierin Detar të Pashalimanit. Në gusht të vitit 2008 hyri në armatim anija e parë “Iliria” P-131 dhe 13 shtatori i vitit 2011 shënon një ditë tjetër të shënuar për Forcat tona Detare, prodhimin e anijes së parë luftarake “Oriku”, P-132 në Kantierin Detar të Pashalimanit, e cila do të ndiqej nga “Lisus”, P133 dhe “Butrinti”, P-134. Ndërtimi i Sistemit të Integruar të Vezhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD), Krijimi i Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), pajisja e Forcës Detare me anije të reja të klasit STAN PATROL 4207, përmirësimi i sistemit të trajnimit, logjistik dhe komunikimit, si dhe përmirësimi i bazës doktrinale, ka bërë të mundur që Forca Detare / Roja Bregdetare sot të jenë një forcë efektive për përmbusjen e misionit të tyre në mbështetje të interesave kombëtare.

Në 90-vjet të ekzistencës të shërbimit të Forcave Detare, kanë shërbyer shumë breza detarësh, por edhe jo detare. 25 dhjetori është një ditë e shënuar që ka nevojë për ringjalljen e kujtesës historike për të gjithë detarët që i kanë shërbyer Shqipërisë, me përkushtimin, profesionalizmin dhe patriotizmin e tyre. Sot është dita për të kujtuar Heronjtë e Popullit Spiro Kote dhe Ilia Kici Dashi; për të kujtuar të gjithë drejtuesit kryesorë të Forcave Detare ndër vite, që me integritetin dhe profesionalizmin e tyre edukuan dhe stërvitën një personel patriot dhe të përkushtuar. Forca jonë Detare është e re, por me një histori të lavdishme në shërbim të atdheut. E tillë do të jetë edhe në të ardhmen. Sfidat e reja në mjedisin e sigurisë detare do të kërkojnë një rol të shtuar të Forcave Detare dhe Rojes Bregdetare. Dhe ato do ta realizojnë me nder këtë rol.



◀ *Është me origjinë nga Vlora, por lindur në Shkodër. Pas përfundimit të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve, në vitin 1980, shërbeu për 18 vite si oficer në Shkodër, ku dhe jetoi deri në vitin 2000. Pra ka jetuar për 43 vite në Shkodër. E quan veten me fat që është lindur dhe rritur në këtë qytet me tradita atdhetare, kulturore, sportive, në atë qytet me bukuri të rrallë e mes njerëzve të mrekullueshëm e plot humor. Por ashtu ndjehet me fat dhe krenar për Shkodrën, po aq krenar ndjehet për Vlorën e historisë, atdhetarizmit, trimërisë, bukurisë, bujarisë etj, por edhe për Dukatin që është vendlindja e prindërve të tij. Ka shërbyer mbi 35 vjet me uniformë ushtarake dhe doli në rezervë me gradën e lartë gjeneralmajor, duke marrë me vete kujtime që duan net të tëra dimri t'i përcjellë mes familjarëve, shokëve, miqve, të afërmve..*



Intervistë me gjeneralmajor Viktor Berdo, ish-zëvendësshefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA

Krenar dhe i vlerësuar për kohën që shërbeva në FA

Intervistoi: ALBERT Z. ZHOLI

Mbi 35 vjet me uniformë ushtarake, me angazhime të shumta dhe detyra të ndryshme komandimi, por edhe shtabi. Si ndihet gjenerali gjatë këtyre javëve të para të daljes në rezervë?

Është e vërtetë që uniformën ushtarake e veshja shumë herët, qysh në vitin 1977, vit kur fillova studimet në Shollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, në Fakultetin Gjitharmësh, Dega Zbulim, por në fakt me të isha familjarizuar shumë më herët, pasi babai im ka qenë oficer. Pra, atë uniformë e mbajta veshur pak më shumë se 38 vjet. Uniformën ushtarake dhe simbolet e saj i kam mbajtur si gjërat më të çmuara dhe i kam konsideruar si simbole të prezantimit me dinjitet të ushtarakut shqiptar tek partnerët ndërkom-bëtarë, në publikun vendas dhe jo vetëm, por mbi të gjitha e kam parë si një aspekt i përgjegjësisë të mëdha, përkushtimit dhe sakrificës që bën ushtaraku ndaj vendit të tij. Karriera ime ka qenë në rritje graduale dhe progresive sa i takon detyrave që kam kryer, si dhe e shoqëruar me angazhime të shumta. Të qenurit në detyra komanduese të niveleve të ndryshme hierarkike të FA, që nga ajo e komandantit të togës, kompanisë, batalionit, brigadës (disa herë), universitetit ushtarak, komandantit të Forcës Tokësore, por edhe në detyra të ndryshme në struktura shtabesh, si në nivel brigade, divizionit apo në Shtabin e Përgjithshëm deri në detyrën e zëvendës Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, ku dhe mbylla karrierën time, nënkupton angazhime të shumta dhe me kohë të pa limituar, vështirësi, përgjegjësi, sfida sakrificale, privacione, vendimmarrje të ndryshme, arritje, mosarritje, dëshpërim, krenari dhe kënaqësi. Të gjitha sa cilësova më lart e shoqërojnë ushtarakun gjatë gjithë karrierës së tij, sepse kjo është

natyra e punës së ushtarakut, kjo është zgjedhja që unë bëra 38 vite më parë. Por e them me sinqeritet që po të kthehesha në kohë prapa, të njëjtën zgjedhje do të bëja dhe sot.

Duke dalë nga shërbimi ushtarak aktiv ndjehem krenar për ç'kam bërë e arritur gjatë karrierës sime ushtarake, për profilin, integritetin dhe lirinë time të pacenuar, që i ruajta me aq shumë kujdes dhe si këmbëva asnjëherë dhe me asgjë, pse jo dhe i keqardhur për disa gjëra që nuk janë bërë siç do duhej, si dhe me përlësinë për t'i shërbyer edhe në të ardhmen me të njëjtin devocion e besnikëri vendit tim.

Keni lindur në Shkodër, me origjinë nga Vlora, dy qytete me tradita të përbashkëta, por edhe me veçoritë e tyre. Çfarë mendoni se keni marrë prej tyre?

Edhe pse jam me origjinë nga Vlora, unë u lindi dhe u rrita në qytetin e Shkodrës, pasi babai im ishte ushtarak dhe shërbeu deri sa doli në pension në atë qytet. Arsimin fillor dhe të mesën i përfundova në qytetin e lindjes. Pas përfundimit të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve, në vitin 1980, shërbeva për 18 vite si ushtarak në Shkodër, ku dhe jetova deri në vitin 2000. Pra kam jetuar për 43 vite në Shkodër. E quaj veten me fat që jam lindur dhe rritur në këtë qytet me tradita historike, atdhetare, kulturore, sportive, në atë qytet me bukuri të rrallë e mes njerëzve të mrekullueshëm. Por ashtu siç ndjehem me fat dhe krenar për Shkodrën, po aq krenar ndjehem për Vlorën e historisë, atdhetarizmit, trimërisë, bukurisë, bujarinë etj, por edhe për Dukatin që është vendlindja e prindërve të mi. Gjithsesi,

për mua të dy këto qytete mbeten dashuria dhe referenca ime nga mendoj se unë kam formuar karakterin tim.

Jeni një ushtarakë me një karrierë të gjatë e të suksesshme, deri në detyrën e lartë të zv.shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA. Si i keni arritur këto?

Që në fillimet e mia si ushtarak e në vazhdimësi u investova në formimin tim profesional dhe u mundova që dijet e mia të vë në shërbim të misionit dhe detyrave që më besuan. Mendoj se deri diku ia kam arritur. Karriera ngandonjëherë është edhe çështje fati, por mendoj se shumë më tepër se kaq ajo është investim në dije, përkushtim, sakrificë dhe obligim ndaj detyrave që të ngarkohen. Gjatë viteve të shërbimit në FA kam pasur një karrierë jo vetëm të suksesshme, por të ardhur në mënyrë të natyrshme, shkallë shkallë dhe në kohën e duhur. Në momentin që vendosa për të hyrë rrugës së karrierës ushtarake çdo gjë e mora seriozisht dhe iu përkushtova këtij profesioni të vështirë dhe kaq të nderuar. Vitet e para të kar-

rierës i kam kaluar me trupa duke filluar nga toga, kompania e deri komandant batalioni zbulimi. Këtë periudhë e quaj si periudhën e hedhjes së bazave të një formimi të qëndrueshëm e afatgjatë profesional, periudhë të formimit të karakterit të fortë të ushtarakut. Kam mendimin se një ushtarak formimin bazë profesional dhe formimin e karakterit të tij e merr nëse ai punon fillimisht me trupa. Duhet të kalosh hallkën e togës, kompanisë e batalionit dhe të rritesh gradualisht. Më pas përfundova e Akademinë Ushtarake 2 vjeçare në Tiranë në vitin 1991. Në vijim kam shërbyer në detyra të ndryshme: shef operativ i Brigadës së Ndërhurjes së Shpejtë në Shkodër, komandant i Brigadës së Këmbësorisë në Malësinë e Madhe, shef zbulimi dhe shef shtabi i divizionit në Shkodër, ku edhe mbyllet karriera ime në këtë qytet, të cilin e adhuroj në maksimum. Pjesa tjetër e karrierës sime vijoi në Tiranë, pasi në vitin 1998 emërohem komandant i Brigadës Komando, njësi elitë e atyre viteve dhe shumë e nevojshme për shtetin. Në vitin 2000 i

kthehem përsëri specialitetit tim të dashur zbuluesit, në detyrën e zëvendës drejtorit të Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm dhe mandej nga viti 2003 e deri në vitin 2007 drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërviçjes po në Shtabin e Përgjithshëm.. Nga viti 2007 deri në vitin 2008, shërbeva në detyrën komandant dhe Zv/Rektor i Universitetit Ushtarak "Skënderbej", e cila më shërbeu si një eksperiencë e re në fushën e arsimit. Në qershor 2008, pasi kisha kryer edhe Kolegjin e Studimeve të Avancuar pranë Akademisë së Mbrojtjes dhe plotësimi të kriterëve ligjore, u promovova në gradën madhore Gjeneral Brigade dhe emërohem Komandant i Brigadës së Reagimit të Shpejtë në Zallherr, detyrë në të cilën shërbeva deri në vitin 2010. Me riorganizimin e FA, në vitin 2010 emërohem komandant i Forcës Tokësore, detyrë në të cilën shërbeu deri në vitin 2012. Në gusht të vitit 2012 gradohem Gjeneral Major dhe emërohem zv.shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA, detyrë të cilën e kreu deri më 16 nëntor të këtij viti dhe ku në mbështetje të ligjit të karrierës ushtarake në FA, për shkak të plotësimi të viteve të qëndrimit në gradën gjeneralmajor me dekret të Presidentit të Republikës, me 19 dhjetor dola në rezervë.

Në gjithë këto detyra, ku secila ka rëndësinë dhe veçantinë e vet, kë do të veçonit dhe pse?

Çdo detyrë ka rëndësinë dhe peshën e vet. E rëndësishme është që ushtaraku të jetë në gjendje të analizojë në çdo kohë, detyrën e ngarkuar, vartësit me të cilët punon, zonën ku shërben dhe mbi bazën e pikësnyimit dhe objektivave të ngarkuara nga eporët të dijtë të menaxhojë drejt resurset e mbrojtjes, pra njerëzit, burimet financiare, logjistike në një të vetëm. Po i bëri mirë këto, nuk ka si të mos jetë i suksesshëm. Detyrat që unë kam kryer do të ndaje në tre nivele. E para detyrat direkt me trupën që përfshijnë ato deri në batalion; e dyta detyrat si oficer shtabi; e treta detyrat komanduese në nivel njësie



e force, por edhe drejtorie a institucioni arsimor etj. Secila nga këto detyra ka rëndësinë dhe veçantinë e vet. E para ke të bësh direkt me masën e ushtarëve, të kalit, të stërvit dhe të mban në formë të mirë fizike dhe shëndetësore për të përballuar stërvitje në terrene dhe kushte moti nga më të vështirat, aq më tepër për zbuluesit. E dyta të formon si oficerë shtabi, pasi vlerësimi dhe analizimi i situatës konkrete luftarake apo edhe të kohës së paqes, ndikon drejtpërdrejt në marrjen e një vendimi të drejtë të komandantit për të cilin punon. E treta përgjegjësia është më e madhe dhe shumë e rëndësishme. Duke i parë në kompleks detyrat që kam kryer, pa nënvleftësuar asnjërin, do të veçoja dy prej tyre;

Të parën kohën që kam shërbyer si komandant i batalionit të zbulimit në Shkodër. Isha i ri, i papërtuar dhe plot energji e dëshirë për të punuar e sakrifikuar edhe nga koha e lirë. Më kujtohet si sot që në periudhën e dimrit e kalonim lumin e Kirit me këmbë për të vajtur më shpejt në repart dhe nuk pyesnim fare për pasojat e shëndetit në vitet e mëvonshme. Atë periudhë 1985-1989 e quaj të veçantë për vetë natyrën e zbulimit me stërvitje të gjithanshme, fushime pa fund verore në bregdetin e Velipojës dhe dimërore në Razëm, me gara zbulimi me të gjitha repartet e zbulimit në shkallë ushtrie, të cilat kërkonin përkushtim, mund e djersë të gjithë ushtarëve, me probleme të shërbimit në pikat e zbulimit në kufi, me aktivitete sportive e kulturore pambarim. Të gjitha këto kryheshin dhe realizoheshin në sajë të një planifikimi ekzakt, të kontributit, bashkëpunimit dhe harmonisë midis ushtarakëve aktiv dhe oficerëve dhe nënoficerëve të batalionit. Të flasësh dhe shkruash për aktivitetin e atij batalioni, për ushtarët dhe oficerët e tij duhen shumë kohë, pasi ka qenë repartit më elitë në divizionin e Shkodrës.

Të dytën dhe më të rëndësishmen, periudhën 1998-2000 ku kreu detyrën e komandantit të Brigadës Komando. Në këtë detyrë vija pas një eksperience të gjatë jo vetëm të punës me trupa, të punës si oficer shtabi, por edhe si drejtues. Vija në këtë detyrë ku shteti kishte nevojë më shumë se asnjëherë për forcat komando. Po të kemi parasysh situatën e krijuar pas ngjarjeve tragjike të 1997 dhe atë të krijuar në shtator të 1998, ku roli i forcave komando ishte më se i nevojshëm. Brigadën Komando e gjeta pjesërisht të ngritur, pasi edhe ajo vuante në një farë mase pasojat e shkatërrimit të vitit 1997. Vëmendja e qeverisë së asaj kohe ishte përqendruar krahas ringritjes dhe konsolidimit të saj, edhe në kryerjen e misioneve dhe detyrave të kohës. Unë dua të përmend në këtë intervistë se përkushtimi, angazhimi, disiplina dhe devotshmëria e personelit të brigadës komando, ushtarë të shërbimit të detyrueshëm aktiv, nënoficerët, oficerët dhe personeli civil ishin në shkallën më të lartë. Me këtë rast unë dua të shpreh mirënjohjen dhe respektin për shërbimin që ata bënë në të mirë të vendit të tyre... Në fund të karrierës sime për tre vjet unë kreu edhe detyrën e zëvendësimit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, detyrë e cila arrin kulmin e karrierës sime, por në të njëjtën kohë edhe mbylljen e saj. Kjo detyrë e nivelit më të lartë strategjik, është e një natyre tjetër dhe të bën që gjërat ti shikosh më në gjerësi e thellësi, ti shikosh nga lart, por duke menduar atë se çfarë presin strukturat poshtë nga lidhshipi ushtarak i nivelit strategjik. Në këtë detyrë ke të bësh me nivele të larta komunikimi e pune, madje jo vetëm brenda FA, por edhe në strukturat e tjera të shtetit, gjithashtu edhe me homologët jashtë vendit. Si në të gjithë karrierën time, edhe në këtë detyrë, mendoj se kam dhënë maksimumin e aftësive dhe të përkushtimit tim.

Duke qenë në detyra të rëndësishme komanduese, keni përgatitur dhe dërguar me qindra ushtarakë në misione paqeruajtëse jashtë atdheut. A keni pasur ndonjë situatë të vështirë që

duhet përmendur?

Pjesëmarrja e Forcave tona të Armatosura në operacionet e mbështetjes së paqes zë fill që në vitin 1996 me nisjen e një kontingjenti të parë në Bosnjë-Hercegovinë dhe pastaj në vitet e mëvonshme në Irak, Çad, Afganistan e tani së fundmi edhe në Mali. Janë me qindra ushtarakë që kanë marrë pjesë në këto misione paqeruajtëse, të cilët me përkushtimin dhe performancën e tyre kanë bërë që të rritet imazhi, vlerat dhe kontributi i FA shqiptare në kuadrin e operacioneve të NATO-s. Kujdes të veçantë në gjithë këto

kanë edhe dhënien e ndihmës popullesive në rastet e emergjencave civile dhe të fatkeqësive natyrore. Në karrierën time si ushtarak kam marrë pjesë ose kam drejtuar disa operacione të tilla, por për nga përmasat e emergjencës, problematikat që ajo shfaqti, si dhe nga pjesëmarrja e trupave, do të veçoja operacionet në dy përmbytjet e fundit në zonën veriore të vendit, në Shkodër e Lezhë, në vitet 2010 dhe 2011. Në këto operacione kanë marrë pjesë me qindra ushtarakë e mjete të forcave, tokësore, ajrore, detare dhe struktura mbështetëse, si dhe disa institu-

brenda forcave tona të armatosura, gjatë karrierës time kam njohur komandantë e shefa të niveleve të ndryshëm, të cilët në shumë aspekte kanë shkëlqyer dhe mbahen mend për mirë edhe sot. Të tillë do të përmend ish komandantin e brigadës së Koplikut, të ndjerin Ivzi Godaj, të cilin pas disa vitesh pata rastin ta zëvendësoja në detyrë. Ai ishte një ushtarak i zoti, profesionalisht tepër lart, komunikues, praktik në zgjidhjen e problemeve dhe për më tepër komunikues me të gjithë. Por mbi të gjitha ai kishte krijuar një emër mjaft të mirë te banorët e Malësisë së Madhe dhe të Shkodrës. Po kështu do të veçoja, ish-komandantin e Divizionit të Shkodrës në vitet 1984-1992, Enver Gaba, njeri i jashtëzakonshëm, me kulturë të gjerë, ushtarak profesionist dhe me përvojë, i qartë dhe me logjikë të ftohtë në vendimmarrje, i papajtuësëm me koniukturat, qofshin edhe politike, njeri që kishte respekt për njerëzit dhe për ligjin. Në biseda me shokët e miqtë e mi e quaj me plot gojën idhulli im, etaloni i një komandanti të mirë, komandanti që do

kjo më bën krenarë. Megjithatë mendoj se për familjet e ushtarakëve duhet bërë më tepër, pasi janë ato që përballojnë jetën familjare, rritjen dhe edukimin e fëmijëve në pjesën më të madhe të kohës, pasi ushtarakët angazhohen në misione për një kohë relativisht të gjatë.

Tani që jeni shkëputur nga jeta si ushtarak aktiv, natyrshëm të pyes: A mendoni se bëtë zgjidhjen e duhur në ato vite të rinisë dhe nëse do t'ju jepej mundësia e zgjedhjes së profesionit, do të zgjidhnit përsëri atë të ushtarakut?

Sot që kanë kaluar mbi 35 vjet si ushtarakë dhe nëse edhe sot do të pyeste dikush, ashtu sikundër ju jeni duke më pyetur, me plot bindje them se kam bërë zgjedhjen e duhur dhe ndihem krenar që për shumë vite shërbeva në radhët e FA, ndjehem krenar dhe në paqe me veten time që dhashë shumëçka të shtrenjtë që pata, ëndrrat, rininë, pasionin, dashurinë për profesionin e ushtarakut, si dhe vitet me të bukura të jetës sime.

Çfarë ju rekomandoni ushtarakëve të rinj për të pasur një karrierë të suksesshme, pse jo si edhe juaja?

Mos u zvarritni, karriera është e juaja, është personale, fitojeni atë me djersë, me studime, me kualifikime, me punë të palodhur dhe me dinjitet. Nëse investoheni në këtë mënyrë suksesi i karrierës tuaj është i pashmangshëm. Edhe nëse nuk morët një gradë, një vend pune, apo një kurs kualifikimi, por keni bërë detyrën tuaj mirë dhe me dinjitet, ju them se keni arritur gjithçka si njeri dhe si ushtarak.

Mbas shumë vitesh nën uniformë, me rregulla ushtarake strikte, si ndjeheni tani dhe a mendoni të keni angazhime të tjera në të ardhmen?

Mendoj se ndryshimi i statusit nuk ka ndikuar në sjelljen time të përditshme. Unë gjatë gjithë jetës sime kam zbatuar me përlujtje, etikë dhe korrektësi ligjet dhe rregullat me të cilat rregullohet veprimtaria e FA dhe që janë të detyrueshme për tu zbatuar nga çdo ushtarak. Liria e mendimit dhe kurajoja për ti thënë gjërat siç i mendoj ka qenë pjesë e qenësishme e karakterit tim, si dhe arma ime më e fortë. Ka qenë kjo arsyeja që unë gjërat i them hapur, patjetër të menduara dhe të argumentuara, por pa ndrojtjen dhe dyshimin nëse do t'i pëlqej apo jo tjetrit. Është e vërtetë që detyra dhe vetë statusi i ushtarakut të privon ose të kufizon në disa gjëra, por jo në gjithçka. Unë nuk besoj që për inerci apo forcë zakoni do nderoj ushtarakisht çdo person civil që do me dalë përpara. Edhe civilët kanë kodin e tyre të përshëndetjes dhe të nderimit madje dhe më të thjeshtë se ne ushtarakët dhe nuk do e kem të vështirë ta zbatoj atë (bëj shaka). Sa i takon angazhime në të ardhmen, për momentin nuk kam ndonjë plan, por tashmë duke qenë "lojtar i lirë", pse jo, nëse dikush ka nevojë për kontributin tim. Mbetem i gatshëm për t'i shërbyer vendit tim me të njëjtin devocion e besnikëri si deri më tani.

A ka gjenerali ndonjë mesazh që do tu përcjellë pjesëtarëve të FA në këto momente të ndarjes nga jeta aktive si ushtarak dhe fillimit të integritimit tuaj në jetën civile?

Në këtë rrugëtimin të gjatë të karrierës time ushtarake kam njohur dhe kam punuar me njerëz me virtyte të larta, të gatshëm dhe të vetëdijshëm për sakrificat që bënin. Ndaj shfrytëzoj këtë rast të shpreh respektin dhe mirënjohjen time të thellë për njerëzit nën uniformë, gjithë ushtarakët pavarësisht statusit të tyre, të cilët bënë të njëjtën zgjedhje dhe sakrificat, si dhe unë, duke shërbyer me vështirësi dhe sfidat e kohës, me ata që ndamë dhimbje e gëzime, vizione e qëndrime të përbashkëta për punën, si dhe kontribuam në përmbushjen e misioneve dhe detyrave, në të mirë të vendit tonë. Mendoj se për të gjitha arsyet që thashë më lart, largohem nga FA krenar dhe me dinjitet. Përcjell urimet më të mira për të gjithë ushtarakët dhe suksese në misionin e tyre fisnik. Suksese FA në rrugën e zhvillimit dhe konsolidimit të tyre.

Për mua do të ngelet e paharruar dhe ndoshta çasti më i vështirë në jetën time, kur si komandant i Forcës Tokësore do të jepja para opinionit publik shqiptar dhe më gjerë lajmin e rënies në krye të detyrës së kapiten Voglit dhe organizimit e pjesëmarrjes në ceremoninë mortore të "Dëshmor të Atdheut". Me këtë rast përulëm me respekt të thellë përpara veprës sublime të dëshmorit të atdheut Kapiten Feti Voglit, si dhe dua të përshëndes dhe të falënderoj gjithë ushtarakët që kanë marrë pjesë në këto misione, direkt me trupa apo edhe në përbërje të shtabeve të NATO-s ku kanë shërbyer.



operacione i kemi kushtuar përgatitjes nga ana profesionale, psikologjike, fizike dhe ruajtjes së gjendjes shëndetësore të kontingjentëve. Mbjaj mend që fillimisht në këto operacione dislokoheshin ushtarakë nga dy repartet elitë të FA, Batalioni Komando dhe Batalioni Special, por më pas me masat e marra, me rritjen e nivelit të përgatitjes së trupave, në këto misione shkuan edhe nënrepartet nga batalionet e këmbësorisë Poshnje, Vau Dejës dhe Zall Herr. Parë në tërësi, për kohën që unë shërbeva në dy njësitë e lartë përmendura, jam shumë i kënaqur nga përfaqësimi i kontingjentëve në këto misione, ku kam patur rastin t'i vizitoj edhe disa herë në Irak dhe Afganistan. Por, siç dihet, në këto operacione patëm edhe një rast fatkeq të humbjes së jetës të Kapiten Feti Vogli, i cili u bë dëshmor i parë atdheut, rënë në krye të detyrës në kuadrin e operacioneve të NATO-s në luftën kundër terrorizmit. Për mua do të ngelet e paharruar dhe ndoshta çasti më i vështirë në jetën time, kur si komandant i Forcës Tokësore do të jepja para opinionit publik shqiptar dhe më gjerë lajmin e rënies në krye të detyrës së kapiten Voglit dhe organizimit e pjesëmarrjes në ceremoninë mortore të "Dëshmor të Atdheut". Me këtë rast përulëm me respekt të thellë përpara veprës sublime të dëshmorit të atdheut Kapiten Feti Voglit, si dhe dua të përshëndes dhe të falënderoj gjithë ushtarakët që kanë marrë pjesë në këto misione, direkt me trupa apo edhe në përbërje të shtabeve të NATO-s ku kanë shërbyer.

Keni kryer detyra drejtuese edhe operacione të emergjencave civile. Çfarë mund të thoni për këto operacione?

FA në misionin e tyre, krahas detyrës kryesore për mbrojtjen e vendit,

cioneve të tjera të shtetit shqiptar. Pjesëmarrja me kapacitete në këto operacione ka qenë e madhe, por edhe mbështetja ka qenë maksimale, si nga Ministria Mbrojtjes, ashtu dhe nga qeveria apo pushteti lokal. Ajo që merr prioritet në të tilla emergjencat është shpëtimi i jetës së njerëzve, i gjësë së gjallë dhe i pronës dhe kjo realizohet nëpërmjet një evakuimi të shpejtë dhe masave parandaluese që duhen marrë. Vjen pyetja, pse unë isha në krye të këtyre operacioneve? Ndoshta nga që pjesa më e madhe e trupave pjesëmarrëse në operacion ishte efektiv i FT dhe unë isha komandant i njësisë së kryesorë, asaj të Forcës Tokësore. Mendoj se në suksesin e operacionit ndikojnë edhe faktorë të tjerë. Pavarësisht vështirësive që vinin nga përmasa që kishte marrë emergjenca, si dhe sasia e efektiveve dhe teknikës të përfshirë në të, drejtimin e këtyre operacioneve ma bënin më të lehtë fakti që po operoja në një zonë që e njihja në detaje edhe në të fshehtat e saj, si dhe meqenëse më jepej rasti dhe isha i obliguar për të ndihmuar njerëz që shumicën e tyre i njihja dhe më njihnin. Pavarësisht sa thashë më lart, arsytet që unë u caktova dy herë rresht në krye të operacionit të emergjencës, e shoh edhe si vlerësim të autoriteteve eprore, për të ma besuar këtë detyrë.

Në jetën tuaj kini pasur si idhull një komandant a drejtues, të cilit jeni munduar t'i ngjani dhe pse?

Ti ngjash tjetrit nuk besoj se është e nevojshme, madje dhe e mundur, ndërsa që ta admirosh dikë apo ta marrësh në referencë për ato gjëra që i vlerëson se janë të mira dhe të dobishme, kjo është normale dhe mund të ndodhë me këdo. Shembuj pozitiv të komandantëve dhe strategëve ushtarakë, referuar përvojës botërore ka plot, por unë do të tregoj që

doja të isha dhe që do mbahet mend gjatë. Mendoj se këtij të fundit "vjedhurazi" i kam marrë diçka nga profili tij. Përfitoj nga rasti për ta përshëndetur dhe shprehur mirënjohje për punën e tij.

Profesioni i ushtarakut ju ka bërë që shpesh t'i mungoni familjes, ndoshta edhe në çaste kritike. A ndjeni ndonjë borxh ndaj familjes, sidomos ndaj fëmijëve?

Profesioni i ushtarakut mbart në vetvete mjaft sakrificat, që duhet të përballohen jo vetëm nga individ, i cili pranon të veshë rrobën ushtarake, por në një masë të konsiderueshme këto vështirësi e sakrificat do ti përballojë edhe familja. Po të bësh një llogaritje të vogël i bie që gati një e treta e kohës ushtarakut i ka kaluar larg familjes duke qenë në gatishmëri, me shërbim, në anije, në llogore, në stërvitje, në misione jashtë vendit dhe në të tjera detyra që i ka diktuar dhe dikton edhe sot koha e situata. Kush e di sa prej ushtarakëve kanë marrë lajmin e lindjes së fëmijës së tij duke u gjendur në detyrë, në shërbim, në gatishmëri, në vendroje, në anije, buzë kufirit etj. Sa festa e gëzime kanë ndarë me shokët larg njerëzve më të afërt, por me një përkushtim për detyrën e profesionin. Kjo e bën ushtarakun më fisnik, më njerëzor dhe më madhor. Ata mbeten të nderuar për atë që kanë bërë, për vlerat e veçanta që kanë manifestuar dhe për sakrificat e bëra në emër të Nderit, Detyrës dhe Atdheut. E natyrisht edhe unë gjatë karrierës ushtarake i kam munguar familjes, prindërve, bashkëshortes, fëmijëve, pra në një farë mënyre i kemi munguar njerëz tjetrit. Edhe unë lajmin kur jam shtuar me të dy fëmijët e kam marrë duke qenë në detyrë. Tashmë që unë kam më shumë kohë të lire fëmijët e mi janë rritur dhe arsimuar, janë bërë zotë të vetvetes dhe

“E kam dashur ushtrinë që kur isha fëmijë. Më ka pëlqyer gjithmonë rregulli disiplina, më ka pëlqyer gjithmonë shpirti i skuadrës”

Elis Arapi,

oficeri i dashuruar me detin

ETLEVA SMAÇI

Në radhët e Forcave të Armatosura nuk janë të paktë djemtë dhe vajzat që shërbejnë me devotshmëri, me ndërgjegje dhe atdhedashuri të lartë. Por një bërthamë e mirë e tyre përveç këtyre vlerave të mrekullueshme, padyshim kanë kuptuar se pa një arsimim të plotë ushtarak, mundësisht edhe të kryer jashtë vendit, pranë akademive ushtarake me përvojë, në raste të caktuara më shumë se njëshkulllore, karriera e tyre nuk do të jetë asnjëherë në maja, atje ku ata ëndërrojnë dhe ne shpresojmë t'i shohim. Këta modele të rinjsh që përgjatë gjithë vitit 2015 i kemi bërë pjesë të gazetës “Ushtria”, në rubrikën “Portret”, janë frymëzues për të gjithë. Në numrin e fundit të këtij viti, personazhi ynë, është nënlejtant Elis Arapi, që me përfundimin e studimeve të larta 6 vjeçare në Akademinë e Marinës në Stamboll, u kthye në atdhe, aspak i detyruar nga kontrata e nënshkruar, por me besimin se mund t'i shërbej Forcave të Armatosura të vendit të tij dhe filloi detyrën e nderuar të ushtarakut, në ishullin e Sazanit, ishulli mitik e strategjik, që gjithmonë ka qenë pika më e rëndësishme e mbrotjes bregdetare për vendin tonë. Po kush është Elisi, si u bë ai pjesë e Forcave të Armatosura dhe çfarë synon ai.

Modeli im i parë ishin ish-ushtarakët e qytetit tim

Elisi vjen nga qyteti i Sarandës. Në familjen e tij nuk ka pasur një traditë të mëparshme ushtarake. Elisi pohon me krenari që është i pari ushtarak në fisin e tij. Por kjo nuk e ka penguar aspak që veten ta shoh të projektuar si ushtarak karriere. Modeli i parë i ushtarakut për të u bënë ish-ushtarakët e qytetit të tij. Ata e frymëzuan së pari me ndjenjën e lartë të miqësisë që demonstronin, edhe pse nuk ishin më bashkë në detyrë. Tek i shihte mbasditeve bashkë,



në raste të caktuara i kishte ndodhur të ndiqte rrëfimet e tyre që jo në pak raste edhe nuk i kuptonte, e kuptoi se ky profesion i pëlqente. Kështu që në përfundim të shkollës së mesme, nuk pati asnjë hezitim për zgjedhjen që do të bënte. Ishte viti 2008 dhe Universiteti Ushtarak “Skënderbej” në Tiranë, do të niste brezin e dytë të diplomuarve të tij. Një universitet që siç e kemi thënë edhe në shkrime

të tjera do të mblidhte rreth vetes maturanët më të mirë të vendit, që do të diplomohesh me jo me një por dy diploma. Elisi u pranua në programin e Menaxhimit. Kjo ishte dhe dritarja e parë për t'u bërë pjesë e një shkolle të lartë ushtarake. Por ëndërrat e Elisit dhe këmbëngulja e tij shkon më larg. Sapo u bë pjesë e Univeristetit Ushtarak, i bindur në rrugën që kishte zgjedhur, përveç

plotësimin të detyrimeve shkollore në mënyrë shembullore, filloi kërkimin që ky shkollim të merrte një tjetër drejtim. Sapo mbaronte mësimin, në atë pak kohë të lirë që i ngelej shkonte dhe paraqitej rregullisht pranë sekretarisë së shkollës për të pyetur nëse kishin nisur aplikimet për Akademitë Ushtarake jashtë vendit. Gjermania dhe Turqia ishin dy vendet e synuara. Çdo ditë merrte të njëjtën përgjigje rutinë “jo or çun nuk ka bursa për jashtë”, në raste të caktuara e shikonin me habi dhe i thoshin “nuk u lodhe duke pyetur”. Derisa një ditë nga ato të shumtat, kur ai kryente ritualin e zakonshëm, por i bindur se bursat do të vinin, mori në dorë formularin e aplikimit për në Turqi. Nuk kishte dyshim në hapin që po hidhte. Kishte mbyllur vitin e parë në Tiranë, në Universitetin Ushtarak “Skënderbej”, e kishte



Elisi vjen nga qyteti i Sarandës. Në familjen e tij nuk ka pasur një traditë të mëparshme ushtarake. Elisi pohon me krenari që është i pari ushtarak në fisin e tij. Por kjo nuk e ka penguar aspak që veten ta shoh të projektuar si ushtarak karriere. Modeli i parë i ushtarakut për të u bënë ish-ushtarakët e qytetit të tij. Ata e frymëzuan së pari me ndjenjën e lartë të miqësisë që demonstronin, edhe pse nuk ishin më bashkë në detyrë. Tek i shihte mbasditeve bashkë, në raste të caktuara i kishte ndodhur të ndiqte rrëfimet e tyre që jo në pak raste edhe nuk i kuptonte, e kuptoi se ky profesion i pëlqente.



njohur nga afër disiplinën ushtarake, jetën në “vllazëri” siç i pëlqen ta quaj atij dhe fati po e sprovonte me një tjetër sfidë. Një tjetër shkollim, një tjetër mundësi.

Studentë në Akademinë 300 vjeçare të Marinës në Tuzla

Mbërritja në Stamboll ishte plot surpriza e të papritura. Kishte fituar të drejtën e shkollimit dhe vitin e parë të mësimin të gjuhës turke do ta ndiqte pranë Shkollës së Lartë të Forcave Ajrore të Turqisë. Kjo shkollë dallon për disiplinën e saj të lartë. Ndoshta ky ishte dhe një fat i madh, pasi shërbeu edhe si një vit i krijimit të një kulture të re, që ai e quan “kultura e pilotëve”, Sepse akademitë ushtarake pavarësisht nga fryma e përbashkët kanë dallimet e tyre. Me përfundimin e vitit shkolror për gjuhën, filloi studimet në Akademinë Ushtarake të Marinës, Akademia Ushtarake e Marinës Deniz Harp Okulu daton prej vitit 1773, në kohë e sundimit të Sulltan Mustafai të III-të. Studentët e parë shqiptarë në këtë Akademi si “miq” shkuan në vitet 1993 – 1994, duke pasuar në vite. Elisi ishte pak i dyzuar fillimisht mes këmbësorisë e marinës. Si një djalë i detit padyshim dashuria për detin nuk i mungonte, por deti për t'u zotëruar do shumë punë e mund. Kështu që vështirësia e parë që ndeshi ishte volumi i madh i njohurive me të cilat duhej të përballlej çdo ditë. Por aq sa e madhe



ishte vështirësia, aq më triumfuese doli kureshtja dhe këmbëngulja. Ndër të parat gjëra që kjo shkollë i nguliti, sigurisht me medotat e saj të "rrepta e klasike" ishte durimi. Sepse një detar mbi të gjitha duhet të jetë i duruar, të dijë të presë pa u nxituara. Ndërsa rrëfen kujton rreshtimet e gjata, mbi dy orë, që të vetmin synim kishin përgatitjen psikologjike. Këtu niste edhe seleksionimi i parë. Jo të gjithë mund t'ja dilnin me një ushtrim të tillë rutinë, që duket fare i thjeshtë në pamje të parë. Shkolla i ngjante një gadishulli të vogël, pothuajse e izoluar jo vetëm nga atraksionet e Stambollit, por edhe nga mjedisi përreth. E konceptuar si një mjedis gjigand stërvitjeje e përgatitjeje gjithçka të fliste në gjuhën e detit. Shkolla të impononte thotë Elisi t'i përgjigjeshe madhësisë dhe seriozitetit të saj. Nga ana tjetër një thirrje e brendshme ishte përfaqësimi sa më dinjitoz i shtetit shqiptar, përfaqësues të të cilit ne ishim. Vazhdim i një tradite shumë të mirë të krijuar nga studentët shqiptarë të brezave të mëparshëm. Me krenari pohon se në këtë akademi të gjithë pohojnë se "si grupi i shqiptarëve nuk ka". Pasi ata kanë përcjellë vlerësimin për njëri-tjetrin, të qënurit një grup kompakt, respektin për jetën ushtarake dhe veneracionin për të gjithë ata që kanë kontribuar

në edukimin e tyre.

Mbresa e emocione

Të bëhesh detar i zoti rruga është e gjatë dhe e mundishme. Nënlejtant Elisi kujton orët e gjata të studimit. Netët e tëra kur zgjimi bëhej në bibliotekë, mes librave plot harta. Por kaq i madh ishte edhe gëzimi në përfundim të tyre me rezultate të shkëlqyera. 6 vite të gjatë të mbushur plot sakrificë duket sikur "harrohen" kur vjen çasti i diplomimit, Ceremonia e diplomimit është padyshim një moment kulmor, por për nga rëndësia që i jepet kësaj ceremonie në këtë akademi, flet vetë pjesëmarrja e figurave më të larta të shtetit turk, duke

nisur nga presidenti, kryeministri, figurat e larta të ushtrisë e deri tek familjarët e ushtarakëve që diplomohen. Diplomoni e tij si oficerë marine ai e shikon si një arritje jo vetëm personale. Së pari këtë arritje ja dedikon familjes së tij, që ishte e pranishme me të ditën e diplomimit

Por deri te mbërritja në këtë ditë Elisi ka shumë momente që dëshiron t'i ndajë me ne. Sot që është një oficer aktiv, kujton kohët e para të hipjes në anijet mësimore të shkollës. Anijet e para nuk ishin më shumë se 30-40 m dhe detyrat ishin të vogla, por tepër të rëndësishme për të kuptuar këtë profesion në çdo detaj. Roli i parë ishte ai i një timonieri, apo ushtari të thjeshtë.



Nënlejtant Arapi ka synime të qarta për të ardhmen. Ai dëshiron të kontribuojë në përmirësimin e imazhit të oficerit të marinës shqiptare, në përfaqësimin dinjitoz të uniformës së marinarit së pari profesionalisht. Për këtë thotë ai rruga më e mirë është shkollimi i pandërprerë, i palodhur qoftë brenda ashtu edhe jashtë vendit. Sidomos të rinjtë nuk duhet të mjaftohen me përfundimin e një cikli shkollimi, por të jenë në kërkim të mundësive të reja.

Apo edhe thjeshtë hedhja e litarit. Viti i dytë ishte më ngazëllyes, pasi ai të fuste në botën e motorëve, duke u ushtruar për përpunimin e tij sipas komandave të kapitenit. Për të kaluar në vitin e tretë tek radari dhe për ta përmbyllur pikërisht me atë që është dhe qëllimi final i gjithë shkollimit, me rolin e komanduesit. Udhëtimet që do t'i ngelen gjatë në kujtesë qoftë në aspektin profesional, qoftë edhe në aspektin e bukurive që ofronin ishin udhëtimet e Mesdheut duke nisur nga Stambolli, më pas në birgjet e Tunizisë, Barcelonës, Napolit e për t'u rikthyer përsëri në Stamboll. Të drejtoje një anije ushtarake rreth 100 m ishte sa krenari aq edhe përgjegjësi. Krahas këtij formimi thellësisht ushtarak, Elisi mori në këtë shkollë edhe një sërë njohurish mbi lundrimin civil. Kjo ishte pjesë e programeve të shkollës. Si një eksperiencë unike në këtë drejtim ai sjellë momentet e udhëtimit të bërë me anije me vela në një distancë prej 350 miljesh nga Stambolli në Izmir. Për këtë lundrim ai u pajis me një licensë për lundrimin me anije me vela. Një udhëtim që zgjati për gati 52 orë. Dalja nga gryka e Bosforit, gryka e Çanakalaë ishte sa e vështirë, aq edhe emocionuese...

Shërbimi në Bazën Ushtarake Detare të gjirit të Vlorës

Në historikun e saj Baza Ushtarake Detare e gjirit të Vlorës, është baza më e rëndësishme detare në vend. Shumë figura të njohura të detarisë kanë filluar karrierën ushtarake të tyre pikërisht në të. E besoj se për çdo të ri që i hyn rrugës së vështirë të oficerit të marinës, fillimi i karrierës në Pashaliman e Sazan është më tepër se një sfidë, është një përvojë që nuk mund të anashkalohej. Të jetosh në ishull, ishullin e Sazanit, nuk është aspak një gjetje letrare, si mund të duket në këto rreshta. Për ushtarakun ishulli është detyra. Marrja e detyrës nga nënlejtant Elisi Arapi, përkoi me emërimin në Bazën Detare të Pashalimanit si komandant anijes P 03. Detyra që ai kryen është një detyrë thellësisht humanitare. Është pikërisht ai së bashku me ekuipazhin e tij, që sapo jepet sinjali SOS nga një peshkarexhë, apo anije tjetër e vogël, të japë ndihmesën e parë. Pra e thënë ndryshe janë gjithmonë në gatishmëri. Duke bërë një krahasim me atë çfarë ka parë e mësuar në Turqi, ai mendon se detaria shqiptare ka akoma nevojë të përmirësohet profesionalisht, pasi ai si komandant anije shpesh herë i duhet të marrë përsipër edhe detyra që nuk i takojnë aspektit komandues por atij zbatues. Me një sens humori, thotë se gjatë kësaj periudhe i ka ndodhur të bëjë edhe detyrën e timonierit, edhe detyrën e motoristit, edhe pse është komandant i anijes. Por këtë e motivon me faktin se detari duhet të dijë gjithçka. Punën që bën e quan të lodhshme, jo thjesht në kontekstin e punës, por për vetë mjedisin ku ajo zhvillohet, në det. Andaj mendon se trajtimi i detarëve duhet të marrë më tepër kujdes e vëmendje, në hartimin e reformave ekonomike për ushtarakët, si dhe në stimulimin e tyre material. Në bazën e Pashalimanit Elisi rivendosi kontaktet me personelin e njësisë logjistike turke të vendosur aty. Fakti që është i diplomuar në Turqi jo vetëm e ka lehtësuar komunikimin, por mban të gjallë shkëmbimin e përvojave mes tyre, kalimin e kohës së lirë etj. Po me të njëjtin emocion ka përjetuar ardhjen e anijeve luftarake minahedhëse turke në qytetin e Vlorës, pasi pjesë e ekuipazhit luftarak të tyre ishin shokët e tij të dikurshëm të shkollës. Kjo e bën krenarë, pasi e sheh brezin e tij jo vetëm t'i shërbejë vendeve të tyre, por të jenë edhe pjesë e aleancës së madhe NATO. Nënlejtant Arapi ka synime të qarta për të ardhmen. Ai dëshiron të kontribuojë në përmirësimin e imazhit të oficerit të marinës shqiptare, në përfaqësimin dinjitoz të uniformës së marinarit së pari profesionalisht. Për këtë thotë ai rruga më e mirë është shkollimi i pandërprerë, i palodhur qoftë brenda ashtu edhe jashtë vendit. Sidomos të rinjtë nuk duhet të mjaftohen me përfundimin e një cikli shkollimi, por të jenë në kërkim të mundësive të reja. Vetëm kështu mund të krijohet elita e re e Forcave të Armatosura që do të trashëgojë me dinjitet punën e bërë në të gjitha forcat nga brezat e mëparshëm.



Nënlolemele ALDA SULA

Qendra e Doktrinės dhe Kërkimit bën bilancin e punës një vjeçare

Përiudha një vjeçare e Qendrës së Doktrinės dhe Kërkimit (QDK), si një institucion funksional kërkimor për doktrinat, kërkime themelore në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe si lider në fushën e standardizimit e mësimave të nxjerra, ka qenë e mbushur me mjaft aktivitete përgjatë 2015. Në procesin e punës gjatë vitit 2015, QDK synoi të përmbushë sfidat më të dukshme në fushën e studimeve dhe kërkimeve të projekteve si ato të mjedisit strategjik të sigurisë, të zhvillimit dhe rishikimit të programeve kërkimore doktrinarë dhe përmirësimit tërësor të metodës dhe praktikës së punës në sektorët e standardizimit e mësimave e nxjerra, standardet dhe përhapjen e njohurive kërkimore në Forcat e Armatosura, duke realizuar kështu misionin e saj.

Në harkun kohor njëvjeçar të qendrës është krijuar besimi se perspektiva do të jetë më e mirë, me më shumë bashkëpunim brenda strukturave të mbrojtjes, e cila do të ndikojë në mënyrë të drejtë në rishikimin e doktrinaeve dhe manualeve, në rritjen e cilësisë së botimeve shkencore, në ratifikimin dhe implementimin e STANAG-ve më të domosdoshëm që i shërbejnë stërvitjes dhe modernizimit të ushtrisë, në mbështetjen e arsimimit, trajnimit të niveleve të ndryshme strukturore dhe të hierarkisë ushtarake duke integruar sigurinë dhe rezultatet e kërkimeve në procesin e kurrikulave dhe të mësimdhënies në institucionet përkatëse.

Në analizën e punës e drejtuar nga komandanti i QDK, kolonel Fadil Grosha, ku mori pjesë dhe komandanti i KDS, gjeneralbrigade DedëPrenga, ndryshe nga herët e tjera, u diskutua me një format të vecantë. Realizimi i objektivave, detyrave të departamentit, problematikave që kanë ekzistuar gjatë periudhës vjetore, me ndikim në ecurinë e realizimit të detyrave me argumentimet përkatëse, si dhe fokusi i punës për të ardhmen, zunë vend në raportimet e secilit departament. Vepërimtaria vjetore 2015, është bazuar në përmbushje të misionit që qendra ka, detyrimeve që burojnë nga dokumentet kryesore të planifikimit për vitin 2015, Direktivës së MM, Udhëzimeve të SHPFA, si dhe ato të komandantit të KDS. Objektivat kryesore të punës një vjeçare të qendrës kanë qenë të fokusuar në kryerjen e studimeve dhe kërkimeve shkencore, në analiza strategjike dhe hartimin e koncepteve të reja në funksion të modernizimit të FA; në ndjekjen e Zhvillimit të Doktrinės së Përbashkët dhe Hierarkisë Doktrinarë në FARSH; në nxitjen e mendimit të përparuar ushtarak, të fokusuar në sfidat e transformimit të FA, nëpërmjet Revistës Ushtarake dhe botimeve të tjera me karakter ushtarak e shkencor; në përgatitjen e Planit të STANAG-ve për t'u ratifikuar dhe ndjekjen e procesit të implementimit të tyre në FARSH, si dhe menaxhimin e procesit të mësimave të nxjerra.

QDK, nëpërmjet Departamentit për Kërkimet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, gjatë këtij viti është përqendruar në realizimin e detyrave kryesore të saj si studime strategjike, projekte studimore, analizat strategjike, zhvillim konceptesh etj. Objekt studimi kanë qenë çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes me formën e projekteve ndikuese për kushtet tona,



sidomos në çështjet e ndryshimeve të shpejta të sigurisë brenda vendit, në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Për periudhën janar-dhjetor 2015, janë zhvilluar 7 (shtatë) analiza strategjike, pesë raste studimore, tre raporte për lidhshirësin kryesor, tetë zhvillime konceptesh, 36 artikuj në gazetën Ushtarake dhe 5 artikuj në revistën Ushtarake. Me anë të këtyre studimeve është synuar përmbushja e sfidave më të dukshme në fushën e studimeve dhe kërkimeve të projekteve si ato të mjedisit strategjik të sigurisë, të zhvillimit të koncepteve dhe të rasteve studimore konceptuale dhe përhapjen e njohurive kërkimore në FA. Ndër to mund të përmëndim: projekti studimor “Fatkeqësitë Natyrore dhe impakti i tyre në Sigurinë Kombëtare”; Vizioni Strategjik. temë studimore për llogari të Akademisë së FA, projekti studimor “Vlerësimi strategjik i konfliktit në Ukrainë dhe mundësitë e transferimit të tij në rajonin e Ballkanit”, prezantimi i projektit studimor “Radikalizmi fetar; shkaqet, dinamika dhe ndikimi i tij në rajonin e Ballkanit”, tema studimore dhe analitike “Anët e forta dhe të dobëta të ISIS dhe operacionet e informimit-Rasti i Shqipërisë”, analiza strategjike me temë: “Aktivitetet dhe operacionet ushtarake të FA dhe mbrojtja e mjedisit”, rast studimor “Konsolidimi i sistemit të komandim kontrollit si parim unik”. Është zhvilluar dhe prezantuar koncepti me temë “Vendi dhe roli i Qendrës së Bashkuar Operacionale në kuadër të komandim kontrollit në FA”, Rast Studimor: Sistemi i ri i gatishmërisë luftarake në FA në përputhje me sistemet e NATO-s, është zhvilluar koncepti me temë: “Roli i ri i FA-së në kuadër të sigurisë së brendshme” etj.

Mbështetur në misionin e përcaktuar, në të cilin zhvillimi i Doktrinės Ushtarake të FARSH dhe procesi i

publikimeve janë parësorë, puna është orientuar në marrjen e masave të nevojshme dhe vendosjen e një bashkëpunimi të frytshëm me të gjitha strukturat brenda FA. Në këtë kuadër, për rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e sistemit aktual të zhvillimit të kësaj doktrine, por edhe të harmonizimit vertikal e horizontal të dokumenteve doktrinarë, rritjes së cilësisë dhe gjithëpërfshirjes së të gjitha hallkave, QDK ka punuar për rishikimin e arkitekturës dhe hierarkinë e doktrinaeve dhe manualeve në FARSH, si edhe për politikave përkatëse në zhvillimin e tyre. Gjithashtu, për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga udhëzimi i SHSHPFA për “Vlerësimin e sistemit aktual të doktrinaeve, manualeve, rregulloreve dhe publikimeve në administrim të strukturave të FA-ve”, QDK ka ndjekur dhe evidentuar ecurinë e hartimit dhe implementimit të Doktrinės së Përbashkët, atyre të forcave, manualeve e rregulloreve të përbashkëta, duke bashkëpunuar e koordinuar ngushtësisht me të gjithë strukturat e FA-ve, me qëllim përpunimin, sistemin, seleksionimin dhe analizimin e të gjitha materialeve, informacioneve, sugjerimeve, rekomandimeve për procesin e publikimit të materialeve doktrinarë etj. Janë zbatuar në vijimësi dhe procedurat për rishikimin periodik të çdo publikimi doktrinar, në përputhje me politikave e publikimeve në NATO dhe me STANAG-ët e ratifikuar. Në këtë aspekt, është përkthyer dhe punuar dokumenti AAP-47 “Allied Joint Doctrine Development” (Zhvillimi i Doktrinės së Përbashkët të Aleancës), ku janë vërejtur risitë që ofrohen në drejtim të konsolidimit të mëtejshëm të procedurave në hartimin, zhvillimin dhe publikimin e dokumenteve doktrinarë në FA; në përcaktimin e saktë të arkitekturës dhe hierarkisë së doku-

menteve doktrinarë, në përputhje me dokumentet e përditësuara të NATO-s, por edhe procedurat formale që ndiqen në përmirësimin e procesit të zhvillimit të Doktrinės së Përbashkët dhe standardizimit të këtij procesi. Si strukturë përgjegjëse për botimin e materialeve dhe dokumenteve të tjera gjithëpërfshirëse, që ndikojnë në veprimtarinë e FA, QDK është angazhuar dhe për Konferencën e SAR dhe Konferencën e Arsimimit Ushtarak në FA, të zhvilluar gjatë vitit 2015, nëpërmjet korrektimit, redaktimit, faqesjes e deri në botimin e librave përkatës. QDK ka punuar vazhdimisht për rritjen e cilësisë së interesit për të në audiencën ushtarake brenda FA, për ta bërë atë sa më atraktive jo vetëm në rrethet akademike, por edhe më gjerë.

Në bazë të Planit Vjetor të ratifikimit të STANAG/AP për vitin 2015, janë miratuar/ratifikuar nga Bordi i Standardizimit 32 (tridhjetë e dy) STANAG/AP (duke e çuar në 257 numrin e STANAG/AP të ratifikuar deri tani në FA), për të cilët u përgatitën Raportet Analitike, si dhe është bërë oponencë e dhënë ekspertizë për çdo STANAG/AP nga personeli sektorit të Standardizimit, si dhe është përgatitur praktika për tu ratifikuar/miratuar në mbledhjet e radhës të BS, në muajin dhjetor po të këtij viti edhe për 15 (pesëmbëdhjetë) STANAG/AP të tjerë. Synimi në këtë drejtim, ka qenë përmbushja me sukses e sfidave në fushën e standardizimit e Mësimeve të Nxjerra, jo vetëm për ratifikimin e STANAG/AP-ve dhe zhvillimin e procesit të analizës për evidentimin e MN nga operacionet e aktivitetet kryesore stërvitore, por veçanërisht për koordinimin dhe bashkërendimin e punës me drejtoritë në SHP/MM



Në procesin e punës gjatë vitit 2015, QDK synoi të përmbushë sfidat më të dukshme në fushën e studimeve dhe kërkimeve të projekteve si ato të mjedisit strategjik të sigurisë, të zhvillimit dhe rishikimit të programeve kërkimore doktrinarë dhe përmirësimit tërësor të metodës dhe praktikës së punës në sektorët e standardizimit e mësimave e nxjerra, standardet dhe përhapjen e njohurive kërkimore në Forcat e Armatosura, duke realizuar kështu misionin e saj.

dhe Komandat Kryesore për implementimin dhe zbatimin e STANAG/AP-ve dhe të Mësimeve të Nxjerra në strukturat e FA. Në kuadër të transformimit, modernizimit dhe trajnimit të FA-së, Mësimet e Nxjerra kanë qenë një tjetër prioritet i QDK. Fokusi kryesor i sistemit të MN kanë qenë misionet dhe operacionet e njësisve të FA-së, brenda dhe jashtë vendit, stërvitjet dhe aktivitetet stërvitore e trajnuese apo vlerësuese të tyre. Gjatë këtij viti nga Sektori i Mësimeve të Nxjerra janë zhvilluar 4 (katër) Raporte Analize, për stërvitjen e F. Tokësore “Fekeni-2015”, “Operacioni KFOR 2014-2015”, “Operacionet e E. Civile të F. Ajrore”, si dhe studimi i Raportit të ardhur nga Qendra e Bashkuar e Analizës dhe Mësimeve të Nxjerra (JALLC) “Për mbështetjen e personelit të dislokuar në operacion”. Në këto raporte të analizave janë evidentuar 17 (shtatëmbëdhjetë) Mësime të Identifikuara, (duke e çuar në 105 numrin e MI deri tani në FA), të cilat janë dërguar në SHP për vazhdimin e procedurave të mëtejshme për kthimin e tyre në Mësime të Nxjerra. Aplikimi i Mësimeve të Nxjerra ka sjellë përmirësim në programet e trajnimit të stërvitjes së kontingjenteve për kryerjen e Operacioneve të Mbështetjes së Paqes jashtë vendit, në operacionet humanitare në ndihmë të popullsisë në Emergjencat Civile brenda vendit, në procesin e edukimit e arsimimit, në përgatitjen e kurrikulave e programeve mësimore, procesit të mësimdhënies e të vlerësimit, si dhe në përzgjedhjen e trupës mësimore në institucionet arsimore të KDS-së.

Edhe për vitin 2016 QDK do të vazhdojë punën në drejtim të punës për hartimin e projekteve studimore në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, të analizave strategjike dhe të rasteve studimore për zhvillimin e koncepteve; për menaxhimin e funksionimit e sistemit të MN dhe procesit të Standardizimit në FA, harmonizimit e procesit të standardizimit me procesin e planifikimit të mbrojtjes, si dhe për mbështetjen e aktivitetit të FA me publikime të nivelit strategjik, operacionale e taktik, rregullore e SOP, në përputhje me dokumentet respektive të NATO-s.

Fuqia luftarake sipas Klauzeviçit dhe pasqyrimi i saj në doktrinat e NATO-s



Nënkolonel DËFRIM HAXHIJA

Politika ndërkombëtare është në vetvete përpjekja që bëhet nga shtetet kombe për fuqi. Fuqia në arenën ndërkombëtare përdoret për mbrojtjen e interesave kombëtare me anë të ndikimit mbi partnerët apo konkurrentët potencial. Instrumenti më i rëndësishëm i fuqisë që mund të zotërojë një shtet-komb është fuqia ushtarake. Hans Morgenthau thekson se veçanërisht në politikën ndërkombëtare, fuqia ushtarake qoftë si kërcënim i drejtpërdrejtë apo si mundësi përdorimi është faktori më i rëndësishëm material që kontribuon në fuqinë politike të një vendi. Elementet e tjerë të fuqisë kombëtare sigurisht që janë të rëndësishëm dhe mund të kontribuojnë për mbështetjen dhe çuarjen përpara të interesave kombëtare; megjithatë, për aq kohë sa shtetet vazhdojnë të jenë në gjendjen e anarkisë, fuqia ushtarake do të vazhdojë të luajë një rol vendimtar në politikën ndërkombëtare. Siç thotë me të drejtë Kenneth Waltz, në politikë thuhet që forca do të jetë mjeti i fundit. Në politikën ndërkombëtare, forca shërben jo vetëm si mjet i fundit, por në të vërtetë si forcë e parë dhe e qëndrueshme.

Përvoja e të gjithë luftërave (operacioneve, luftimeve), ka treguar se suksesi është arritur nga ajo palë, që ka ditur ose ka shfrytëzuar atë kohë që ka pasur, apo ka krijuar fuqinë luftarake superior mbi kundërshtarin në vendin dhe në kohën e duhur. Me fuqi luftarake kuptojmë aftësinë për të luftuar. Shkatërrimi/asgjësimi i forcave të armikut është një nga qëllimet, që mund të ndeshet në luftë. Sot mund të ketë raste që nëpërmjet “kërcënimit të përdorimit të forcës” të arrihen ato synime politike, që mund të arriheshin nëpërmjet operacioneve ushtarake. Në luftë/operacion/luftim ka një mjet të vetëm, ndeshjen. Kjo është në fund të fundit e vetmja shfaqje, e vetmja veprimtari e efektshme e luftës/operacionit/luftimit, pasi asgjësimi i armikut, që është qëllimi i tij, bëhet gjatë ndeshjes dhe nëpërmjet saj, ka theksuar Klauzeviçi.

Operacionet konvencionale të kohëve të fundit si në Kosovë, Afganistan, Irak, Siri etj., vetëm e konfirmojnë në mënyrë më të qartë këtë mbizotërim të tyre. Siç është vënë në

dukje kohët e fundit nga Robert Art, fuqia ushtarake, aq sa është e rëndësishme për funksionimin e sistemit ndërkombëtar, aq është edhe një instrument shumë i kushtueshëm dhe i rrezikshëm i qeverisjes, që nuk duhet të ushtrohet asnjëherë pa një mënçuri dhe efektshmeri të madhe.

Përdorimi korrekt i fuqisë ushtarake nuk jep sigurinë që shteti do të mbrojtë të gjitha interesat e tij, por përdorimi jo korrekt do të vendosë një barrë të rëndë në instrumentet e tjerë të fuqisë kombëtare dhe mund t'a bëjë

kundër kundërshtarit. Qëllimi i tyre është të kombinojnë në mënyrë të atillë këto elemente që t'i përdorin në pikën vendimtare (qendrën e rëndësës) për kryerjen e misionit me sa më pak kosto.

Po nuk u ndeshe, po nuk u ballafaqove me armikun, nuk mund të arrish asnjë synim apo qëllim. Të gjitha kombinimet që mund të bëhen në përdorimin e forcave, të armëve dhe zjarrit, nuk mund të mospërbajnë edhe rrezikun, që po me këto kombinime që mund të bëjë

KLAUZEVIÇ

Në luftë, ka thënë Klauzeviçi, gjithçka është shumë e thjeshtë, por gjëja më e thjeshtë nuk është e lehtë. Duke pasur parasysh shprehjen e Klauzeviçit, arrijmë në një përfundim që duhet mbajtur në konsideratë, që fuqia nuk është një shprehje aritmetike. Çdo llogaritje thjesht mbi bazën e manualeve, nuk është e drejtë dhe nuk duhet bërë. Rastet e shumta të historisë së luftërave dhe operacioneve, kur forca numerikisht më të vogla, më pak të armatosura, kanë arritur të fitojnë e dëshmon më së miri këtë

të pamundur për një shtet përmbushjen e objektivave të tij. Vendimet, nëse duhet përdorur fuqia ushtarake dhe si duhet përdorur ajo, mund të jenë kështu më të rëndësishmit që mund të marrë një shtet.

Fuqia luftarake nënkupton forcën shkatërruese ose çarëse që një njësi ose formacion ushtarak mund të aplikojë kundër kundërshtarit në një kohë të caktuar. Është aftësi e komandantit për të luftuar në operacione të ndryshme, është aftësi për të realizuar misionin. Përcaktimi i fuqisë luftarake është një çështje e rëndësishme që merret në konsideratë në planëzimin që bëhet në shtabet ushtarake dhe komandantët, por siç theksohet në të gjitha dokumentat dhe nga përvoja në operacione e shumë ushtrive të tjera është bile shpesh kritike për suksesin e operacionit analizimi i saktë i elementeve të fuqisë luftarake, qoftë i armikut qoftë i forcave tona.

Analizat që bëhen gjatë planëzimit dhe kryerjes së operacioneve luftarake tregojnë për rëndësinë e madhe të fuqisë luftarake në kryerjen e misionit. Ajo është një kombinim i efekteve të manovrës, të fuqisë së zjarrit, të mbrojtjes dhe të lidhshimit. Ajo është një masë e efektit të përgjithshëm të një force dhe përfshinë: numrin, armët, disiplinën, nivelin e stërvitjes, mjeshtrinë taktike, aftësinë luftarake, moralin, vendosmërinë, pajisjet dhe mjetet mbështetëse. Komandantët i kombinojnë elementet e fuqisë luftarake për të plotësuar në mënyrë konstante ndryshimin e kërkesave dhe për të shkatërruar kundërshtarin. Komandantët integrojnë dhe aplikojnë efektet e këtyre elementeve me mbështetjen me shërbime të luftimit

si kundërpërgjigje kundërshtarit, të bëjë të paefektshme këto. Do të ishte e gabuar se pa një analizë të thellë të kushteve e faktorëve të të dyja palëve, të hidhesh në mësymje apo të kalosh në mbrojtje. Për shembull të “aventurosh”, të hidhesh në mënyrë të verbër në vend të asgjësosh kundërshtarin armik, do të vësh para asgjësimit forcat tona, ose dhe po të fitosh, fitorja do të jetë me humbje shumë të mëdha.

Efikasiteti më i lartë i takon jo mjetit (forca të gjalla, armë, etj) por qëllimit. Kjo ka qenë dhe mbetet gjithmonë dukuria kryesore në çdo operacion (luftim). Fitoret “si të Pirros”, asnjëherë nuk janë të leverdishme, dhe kjo është kryesore. Prandaj gjithmonë theksohet që plotësimi i detyrës së operacionit, plotësimi i misionit, të bëhet në kohën më të shkurtër, me humbje më të pakta dhe shpenzime më të vogla. Shpesh herë gjejmë shprehje të tilla si përqëndrimi i forcave dhe i mjeteve, i fuqisë luftarake, i përpjekjeve etj. Theksoj, që sido qofshin këto, thelbi i kuptimit dhe përmbajtjes së tyre, në fund të fundit është dhe ka të bëjë me “fuqinë luftarake”.

Përqëndrimi i forcave ka të bëjë me fuqia luftarake e cila duhet të përqëndrohet në vendin e përzgjedhur me synim arrijtjen e rezultateve vendimtare. Ndërsa suksesi ushtarak në betejë kushtëzohet nga përqëndrimi i fuqisë luftarake superiore në vendin dhe kohën vendimtare. Me fuqi luftarake kuptojmë tërësinë e mundësive të një fuqie dëmtuese dhe asgjësuese që një njësi (veprat, mënyrat) ushtarake mund të realizojë kundër qëndresës së rëndësës së armi-

Rubrika: Flasin studentët e Kursit të Lartë të Oficerit në AFA

Studentët pjesëmarrës në KLO kanë nisur realizimin e detyrave individuale, sipas temave të lëndës “Teori të luftës dhe strategjisë”, nën drejtimin e pedagogut Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj. Me këtë rast, gazeta “Ushtria” çel rubrikën “Flasin studentët e Kursit të Lartë të Oficerit në AFA” nëpërmjet së cilës do të pasqyrojë herë pas here esse, recensa dhe opinione të përzgjedhura nga studentët pjesëmarrës në këtë Kurs, të cilat gjykojmë se vlejnë të njihen dhe studiohen edhe nga ushtarakët të tjerë të niveleve të ndryshme të Forcave tona të Armatosura.

kut në një kohë të dhënë”.

Dihet që çdo njësi (repart) hyn në luftë (operacion, luftim) me një përbërje të caktuar në njerëz dhe armatim. Gjithashtu për plotësimin e misionit atyre mund t'u jepen në vartësi apo të mbështeten dhe me njësi apo repartet tjera. Por në çdo rast, për t'i diktuar armikut vullnetin e vet dhe për të plotësuar detyrën, njerëzit (efektivat) përdorin armët dhe fuqinë e tyre zjarrit. Pikërisht fuqia e njësisë (repartit) matet nëpërmjet asgjësimit (kopjes rob) të kundërshtarit dhe plotësimit të misionit të ngarkuar. Pra në fund të fundit fuqia luftarake përcakton fatin e një beteje apo luftimi. Siç u theksua fuqia është aftësia për të luftuar.

Në luftë, ka thënë Klauzeviçi, gjithçka është shumë e thjeshtë, por gjëja më e thjeshtë nuk është e lehtë. Duke pasur parasysh shprehjen e Klauzeviçit, arrijmë në një përfundim që duhet mbajtur në konsideratë, që fuqia nuk është një shprehje aritmetike. Çdo llogaritje thjesht mbi bazën e manualeve, nuk është e drejtë dhe nuk duhet bërë. Rastet e shumta të historisë së luftërave dhe operacioneve, kur forca numerikisht më të vogla, më pak të armatosura, kanë arritur të fitojnë e dëshmon më së miri këtë. Edhe formula e “ligjit të epërsisë numerike” e Klauzeviçit që $P = N.V.Q$, ku N-numri i trupave; V-koeficientët e ndryshueshëm të ndikimit të rrethanave luftarake; Q-vlera e cilësia luftarake e trupave duhet plotësuar e llogaritur me ato elemente e faktorë që përmendëm më lart. Po kështu duhet të evidentojmë se jo të gjithë ato elementë, në momente apo faza të përgatitjes, zhvillimit e përfundimit të operacionit, kanë vlerë të njëjtë. Vlera e tyre del në pah në momente të caktuara dhe shpesh ndërrojnë rolet me njëra tjetrën. Në një moment merr vlera më të mëdha nisma; në një tjetër befasia; në një tjetër manovra etj. Përvoja ka treguar, që rritja numerike, mbi atë që është e nevojshme për plotësimin e detyrës, jo vetëm që nuk ekonomizon forcat, por sjell ndonjë ndryshim

cilësor në operacion. Përkundrazi ajo mund të çojë trupat në pasivitet.

Një karakteristikë e fuqisë luftarake është relativiteti i saj. Me këtë kuptojmë se ajo në ecurinë e operacionit mund të ndryshojë. Prandaj krijimi i epërsisë për shembull në të gjitha aspektet në fillim të operacionit, duhet mbajtur gjatë gjithë ecurisë së tij, nëpërmjet përdorimit të rezervave (skalioneve të dyta) në kohën e vendin e duhur, nëpërmjet shfrytëzimit të terrenit, manovrës, shpejtësisë, thyerjes së kundërsulmeve të armikut, nëpërmjet prishjes së planeve të tij etj. Sipas AJP-01(D), në përcaktimin e fuqisë luftarake ka pak rëndësi sa të avancuara janë platformat, armatimet apo sensorët e njësive aleate, nëse njerëzit që i drejtojnë ato janë të pamotivuar, janë të patrajnuar apo u mungon lidhshimi i duhur. Nga ana tjetër, komponentët nuk janë të pavarur nga njëri-tjetri, secili prej tyre integrohet me të tjerët.

Faktorët nga të cilët varet fuqia luftarake, kërkojnë nivel të lartë komandimi e drejtimi, nivel të lartë të përgatitjes së efektivave dhe sigurimit të gjithanshëm e të vazhdueshëm material e shndetësor, shfrytëzim të karakteristikave të terrenit dhe kushteve të motit. Analiza e fuqisë luftarake është e vështirë, kërkon aplikimin e të dyjave, të artit dhe të shkencës ushtarake. Kombinimi i elementeve të fuqisë luftarake kryhet për të plotësuar në mënyrë konstante ndryshimin e kërkesave dhe për të shkatërruar kundërshtarin. Komandantët duhet të integrojnë dhe aplikojnë efektet e këtyre elementeve me qëllim që t'i përdorin në pikën vendimtare (Qendrën e Rëndësës) duke siguruar kryerjen e misionit me sa më pak kosto.

Doktrinat ushtarake edhe në të ardhmen duhet të analizojnë më gjerë elementet e fuqisë luftarake, të përshkruajnë përdorimin e saj në lloje të ndryshme të operacioneve ushtarake. E rëndësishme do të ishte edhe përcaktimi i një metodologjie më të saktë për analizën e fuqisë luftarake në të gjitha llojet e operacioneve.

Mesazhi i fund vitit për trupat e NATO-s

Jens Stoltenberg: "Mirënjohje për burrat dhe gratë që shërbejnë nën flamurin e NATO-s. Faleminderit që na mbani të sigurt dhe që mbroni vlerat tona!"

Kam qenë me të vërtetë i privilegjuar gjatë këtij viti për të takuar shumë ushtarë të NATO-s, burra dhe gra nën uniformë, në mbarë botën.

Këtu në Shtabin e NATO-s, ne kemi marrë vendime shumë të rëndësishme për çdo ditë. Por jeni ju ata të cilët ofrojnë sigurinë për të gjithë ne. Ju jemi me të vërtetë mirënjohës.

E fillova vitin duke vizituar trupat tona në KFOR, në misionin tonë të gjatë. Ata kanë ndihmuar për të bërë më të sigurt Kosovën dhe të gjithë ata që jetojnë atje. Ata ndihmojnë për të bërë Ballkanin Perëndimor më të qëndrueshëm. Kjo është një histori suksesi. Në Afganistan, trupat tona tani ofrojnë trajnime, këshilla dhe ndihmë të forcave lokale të sigurisë. Ky është një mision jo-luftarak, por mbetet një mision i vështirë dhe jetik për sigurinë tonë, në shtëpitë tona. Kam takuar gjithashtu shumë prej trupave tona gjatë ushtrimeve kryesore, nga lindja në jug të aleancës sonë, nga Polonia në Portugali. Pashë aftësitë e tyre të jashtëzakonshme dhe përkushtim në vendosjen e parë të Forcës tonë të re majë shtize, në stërvitjen tonë më të madhe në më

shumë se një dekadë, në hapjen e selisë tonë të re në Evropën Lindore. Kam parë personelin tonë ushtarak në shumë vende të tjera, nga Balltiku, deri në Detin Mesdhe dhe në Oqeanin Indian. Së bashku, ne dërgojmë një mesazh të qartë, NATO nuk kërkon konfrontim me askënd. Por ne jemi të gatshëm për të mbrojtur të gjithë aleatët kundër çdo kërcënimi. Tashmë që kemi ardhur në fund të vitit, ne kujtojmë se sa me fat jemi që jetojmë në shoqëri të hapura dhe gëzojmë paqen dhe lirinë. Më lejoni të shpreh mirënjohjen time për ju, burrat dhe gratë që shërbeni nën flamurin e NATO-s. Faleminderit që na mbani të sigurt dhe që mbroni vlerat tona.

Ne gjithmonë nderojmë dhe kujtojmë ata që sakrifkuan jetën e tyre. Ata që vuajnë nga plagët e dukshme dhe të padukshme. Ne i falënderojmë ata për shërbimin e tyre. Ju jemi mirënjohës familjeve dhe të dashurve të tyre. Kudo që mund të jenë, të qëndrojnë të sigurt.

Ju uroj një sezon të mrekullueshëm pushime dhe një vit të ri të qetë!



IFOR, 20 vjet nga misioni i parë i madh, paqeruajtës i NATO-s

MIMOZA GOLIKJA

Kanë kaluar 20 vjet që nga fillimi i operacionit të parë paqeruajtës të aleancës. Forca e Zbatimit (IFOR), e udhëhequr nga NATO, u vendos në Bosnjë dhe Hercegovinë më 20 dhjetor 1995, pas negociatave të suksesshme të marrëveshjes së paqes të Dejtonit. "Angazhimi i NATO-s në Bosnjë dhe Hercegovinë për qëndrueshmëri dhe siguri është sanksionuar në Dejton 20 vjet më parë dhe mbetet i paprekur edhe sot. Ne erdhëm për të ndihmuar sigurimin e paqes në fund të një konflikti të tmerrshëm. Sot, Bosnja dhe Hercegovina është një vend shumë i ndryshëm. Paqësori i qëndrueshëm dhe duke ecur drejt një të ardhme më të mirë në rrugën drejt integritimeve euro-atlantike", ka thënë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. "Ne kërkojmë një Ballkan Perëndimor ku njerëzit të jenë në gjendje të jetojnë si fqinj, në paqe dhe me respektimin e të drejtave të të gjitha komuniteteve".

Misioni i IFOR filloi pas përfundimit të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë më 21 nëntor 1995, pas arritjes së marrëveshjes së paqes në një bazë të forcave ajrore amerikane në Dejton, Ohajo. Një muaj më vonë, më 20 dhjetor 1995, trupat nën misionin IFOR, udhëhequr nga NATO u vendosën në Bosnjë dhe Hercegovinë për të zbatuar marrëveshjen. Ky ishte operacioni i parë i NATO-s në një vend jashtë territorit të aleancës.

Në kulmin e tij, IFOR përbëhej nga 60.000 trupa të nxjerra nga vendet aleate dhe vendet partnere, përfshirë edhe nga Rusia. IFOR operoi sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, nga i cili rrjedh mandati i tij, nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Detyra kryesore IFOR-it ishte për të ruajtur paqen dhe për të veçuar Forcat e Armatosura të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës nga ato të Republikës Srpska. IFOR gjithashtu mbikëqyri demarkacionin e vijave kufizuese dhe heqjen e armëve të rënda. Operacioni IFOR u zëvendësua në dhjetor të vitit 1996 nga Forca Stabilizuese, e udhëhequr nga NATO, (SFOR), e cila ishte më e vogël në madhësi dhe që kishte një mandat tjetër. Në vitin 2004, Bashkimi Evropian mori përsipër rolin e stabilizimit. NATO ofroi planifikim dhe mbështetje logjistike në përputhje me marrëveshjet Berlin Plus rënë dakord midis dy organizatave. NATO mban një shtab në Sarajevë që i ofron këshilla Bosnjës dhe Hercegovinës në



reformën e mbrojtjes, koordinon aktivitetet e partneritetit dhe mbështet përpjekjet e vendit në integrimin euro-atlantik. Bosnja dhe Hercegovina u bë një vend partner i NATO-s në vitin 2006 dhe është aplikant për anëtarësim në NATO.

Nga marrëveshja e Dejtonit drejt operacioni i parë të madh paqeruajtës i NATO-s

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë gjatë fillimit të viteve 1990, Bosnja dhe Hercegovina multi-etnike u hodh në një konflikt të përgjakshëm dhe të zgjatur. Gjashtë ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit, NATO vendosi forcën e Zbatimit (IFOR) në Bosnjë dhe Hercegovinë. IFOR përbëhej nga 50.000 trupa të ofruara nga vendet anëtare të NATO-s dhe 10.000 trupa dhënë nga kontribuesit jashtë NATO-s. NATO u përfshi për herë të parë në konfliktin boshnjak në vitin 1992, me kërkesë të Kombeve të Bashkuara (OKB), për të zbatuar sanksione ekonomike, një embargo armësh dhe një zonë ndalim-fluturimi. Këto masa ndihmuar uljen e luftimeve dhe shpëtime të jetëve, por rezultuan të pamjaftueshme për t'i dhënë fund konfliktit. Në shkurt të vitit 1994, pas sulmit vdekjeprurës me mortaja në një treg të Sarajevës, OKB-ja i kërkoi NATO-s për të kryer sulmet ajrore kundër mbrojtjes ajrore serbe të Bosnjës, instalimit

të komandës dhe kontrollit dhe objekteve të municioneve. Këto sulme ajrore ishin të dobishme për të sjellë palët në tryezën e bisedimeve në Dejton, Ohajo (SHBA) dhe përfundimin e luftës. Më 20 dhjetor 1995, vetëm gjashtë ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit, NATO vendosi Forcën e Zbatimit (IFOR) mandatar nga OKB. Ky ishte operacioni i parë paqeruajtës i madh i NATO-s, operacioni i parë i madh i reagimit ndaj krizave. Forca e Zbatimit udhëhequr nga NATO (IFOR) u vendos për të zbatuar aspektet ushtarake të Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit dhe u zëvendësua një vit më vonë nga Forca e Stabilitetit (SFOR), e udhëhequr nga NATO. SFOR ndihmoi për të ruajtur një mjedis të sigurt dhe lehtësimin e rindërtimit e vendit në prag të luftës së viteve 1992-1995.

Qëllimi dhe zbatimi i IFOR dhe SFOR

Forca e Zbatimit (IFOR) u vendos në Bosnjë dhe Hercegovinë në dhjetor 1995 me një mandat njëvjeçar. IFOR operoi sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB, që rrodhi autoritetin e tij nga Rezoluta e OKB-së Këshillit të Sigurimit (RKSKB) 1031 të 15 dhjetorit 1995. Kjo i dha një mandat jo vetëm për të ruajtur paqen, por edhe, kur është e nevojshme, për të zbatuar atë. Si i tillë dhe në mënyrë rigorozë, IFOR ishte një operacion i zbatimit të paqes, që ishte

më zakonisht i referuar si një operacion i mbështetjes së paqes. IFOR-i synoi të mbikëqyri zbatimin e aspekteve ushtarake të Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit, marrëveshja i dha fund luftës në Bosnjë. Detyra kryesore ishte për të garantuar fundin e armiqësive dhe të ndante Forcat e Armatosura të Federatës së Bosnje-Hercegovinës, nga njëra anë, dhe të Republikës Srpska, në anën tjetër. IFOR mbikëqyri transferimin e territorit në mes të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republikës Srpska, demarkacionin e kufirit ndërmjet entiteteve dhe heqjen e armëve të rënda në zonat e miratuara. Ndërsa situata në terren ishte përmirësuar, IFOR filloi ofrimin e mbështetjes për organizatat e përfshira në mbikëqyrjen e zbatimit të aspekteve civile të Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit, duke përfshirë Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Kombeve të Bashkuara. Qëllimet IFOR-it në thelb janë kryer që nga zgjedhjet e shtatorit të vitit 1996. Ndërsa situata ishte ende potencialisht e paqëndrueshme dhe shumë aspekte të tjera kishin mbetur për tu realizuar në anën civile, NATO ra dakord për të vendosur një forcë të re Stabilizuese (SFOR) që nga dhjetori i 1996.

Forca e Stabilizimit (SFOR) operoi sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, që rrjedh autoritetin e saj nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1088 të datës 12 dhjetor 1996. Siç ishte rasti për IFOR-in, ky ishte një operacion i zbatimit të paqes që ishte më zakonisht i referuar si një operacion në mbështetje të paqes. Detyra kryesore e SFOR-it ishte që të kontribuonte për një ambient të qetë dhe të sigurt të favorshëm për rindërtimin civil dhe politik. Në mënyrë të veçantë, SFOR kishte për detyrë të pengonte ose parandalonte rifillimin e armiqësive; për të promovuar një klimë në të cilën procesi i paqes mund të vazhdonte për të ecur përpara; dhe, për të siguruar mbështetje selektive brenda mjeteve dhe aftësive të organizatave civile të përfshira në këtë proces të saj. Aktivitetet për të shkonin nga patrullimi dhe ofrimi i sigurisë në zonën përmes reformës së mbrojtjes mbështetjen dhe mbikëqyrjen e operacioneve të qendrimit, për të arrestuar individët e paditur për krime lufte dhe ndihmuar kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre.

Mbajtja e paqes dhe kontributi në rindërtim

Trupat e SFOR kryen patrullime të rregullta gjatë gjithë Bosnjës dhe Herce-

govinës për të mbajtur një ambient të sigurt. Njësitë e specializuara shumëkombëshe u vendosën për t'u marrë me rastet e trazirave. SFOR gjithashtu mblodhi dhe shkatërroi armë të paregjistruara dhe armatimet në duar private, në mënyrë që të kontribuonte në sigurinë e përgjithshme të popullsisë dhe për të ndërtuar besimin në procesin e paqes. Vetëm në vitin 2003, SFOR asgjësoi më shumë se 11.000 armë dhe 45.000 granata. SFOR ishte gjithashtu një nga disa organizatat të përfshira në demontimin në Bosnjë dhe Hercegovinë. Forcat e NATO-s kryen disa çmimine dhe ndihmuar për të ngritur shkolla të demontimit në Banja Luka, Mostar dhe Travnik. SFOR gjithashtu ndihmoi për të krijuar një shkollë të trajnimit të qenve antidrogë në Bihaç. Për më tepër, SFOR Specializoi Njësitë Shumëkombëshe (MSU) që ndihmuar misionin policor të BE (EUPM). EUPM ishte përgjegjës për të ndihmuar autoritetet e Bosnjës të zhvillonin forcat lokale policore që të plotësonin standardet më të larta evropiane dhe ndërkom-bëtare, përmes kapaciteteve menaxhuese dhe operacionale, monitorimit, udhëzimit dhe inspektimit të policisë. Përveç kësaj për të ndihmuar organizatat e tjera që punonin në rindërtimin e Bosnje dhe Hercegovinës, SFOR nisi projektet e veta të bashkëpunimit civil- ushtarak (CIMIC) në fusha të tilla të ndërtimeve strukturore dhe të transportit. SFOR ka marrë pjesë në mirëmbajtjen dhe riparimin e rrugëve dhe hekurudhave në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe agjenci të tjera ndërkombëtare. Kjo punë ishte kritike për të siguruar lirinë e lëvizjes në të gjithë Bosnje-Hercegovinës.

Si për të gjitha operacionet e NATO-s, kontrolli politik dhe koordinimi janë dhënë nga Këshilli i Atlantikut të Veriut, organi më i lartë vendimmarrës politik i NATO-s. Komanda strategjike dhe kontrolli u ushtrua nga Shtabi Suprem të Fuqive Aleate të NATO-s në Evropë (SHAPE) në Mons, Belgjikë. Gjatë këtyre misioneve, një total prej 36 vende aleate dhe partnere kontribuan me trupa. Përveç kësaj, ushtarë nga pesë vende që nuk ishin as anëtarë të NATO-s dhe as vende partnere morën pjesë në kohë të ndryshme, siç ishin Argjentina, Australia, Kili, Malajzia dhe Zelanda e Re. IFOR, forcë prej 60.000 trupash u vendos për një vit kurse SFOR, fillimisht përbëhej nga 31.000 trupa, deri në fillim të vitit 2001 u reduktua në 19.000, në pranverën e vitit 2002 u mor vendimi për zvogëlimin e trupave në 12.000 deri në fund të vitit 2002, dhe në vitin 2004 arriti në 7.000 trupa.

Dy përjetime në prag të Vitit të Ri

ALBERT Z. ZHOLI

Vogëlushja shqiptare që e donte jetën...

Me ftesë të një mikut tim, Vitin e Ri 1997 e festova në Glifadha, një nga lagjet më të bukura, më të pastra e më të pasura të Athinës. Ishin vitete e lulëzimit të qytetit të lashtë grek. Në sheshin e lagjes ishte ndërtuar një podium gjigand, ku do të ngjiteshin fëmijë të shumtë. Gjithë gëzimi i shprehur siç dinin e siç donin ata, aty do të ngjitej. Fëmijët të habisnin me shumëllojshmërinë e veshjeve... Nga orkestra u dha sinjali i fillimit të koncertit. Duartrokitje, brohoritje, përqaftime e gëzim i papërmbajtur. Podiumi u mbush plot. Fëmijët shfaqnin gëzimin e tyre, ndryshe nga të gjithë ditët. Më tërhoqi shikimin një vajzë 6-7 vjeçare, që vallëzonte habitshëm. Doja të pyesja, por nuk kisha se kë dhe në atë shpërthim feste, dilje jashtë loje të bëje pyetje. Kërcimtarja e vogël, mbaroi rrotullimet vallëzuese dhe mori në dorë mikrofonin dhe thirri: "Mama, afti ine i zoi!". (Mama, kjo është jeta!). Kështu përkthehen në shqip këto fjalë. Ndjeva një fluturim shpirti. Dhe unë e harrova jetën e halleve në ato çaste... Skena sa nuk shembej nga vallet e fëmijëve dhe të prindërve, që ishin ngjitur, kush mundëte. Kur mbaruan dallgët e gëzimit, zbret nga skena vogëlushja balerinë dhe vjen aty, pranë meje, ku kishte prindërit.

- "Po se lene pedhi mu?" (Si të quajnë?) - e pyeta në greqisht.

- Vasenka Paço! - u përgjigj vajza po greqisht.

- Shqiptare?!

- Po, nga Shkodra jam, - u përgjigj saktë vogëlushja.

Një ndjenë entuziasmi dhe krenarie më mbushi shpirtin. E përqafova mallshëm Vasenkën e vogël. Për një moment mu duk sikur kisha pranë gjithë fëmijët e vëndit tim, Shqipërisë. Dhe dhe një lot m'u këput brenda gjoksit...

Por varfëria s'të lë...

Pas gati një muaji, kur viti i Ri kishte kaluar, përjetova një tjetër moment, por këtë radhë më tronditës. Ishte koha kur shqiptarët për së dyti merrnin rrugën e ikjes së madhe pas përmbysjes së firmave piramidale... Iknin ku të mundnin, ndoshta dhe pa adresë. Iknin për sigurinë e fëmijëve. Befas dëgjoj zilen e telefonit. Ishte mbrëmje.

- Alo Berti? Bashkimi jam!

- Nga flet, nga Shqipëria? - e pyes.

- Jo, nga Janina, jam nisur me gjithë familjen për në Athinë. Po largohem, s'më ka mbetur asgjë në atdheun tim...

E kisha njohur vite më parë, spese ai kishte qenë edhe në fillimvitet '90-të në Greqi. Tashmë po kthehej sërishmi me duar në xhepa. Pra, Bashkimi kishte marë prap udhët larg atdheut, jo vetëm tashmë si vite më parë, por me gjithë gruan dhe djalin pesë vjeçar. I thashë se do të dal të të presë te stacioni autobusave. Sa zbritën nga autobusi, Albanin e vogël mora në duar. Dukej i lodhur dhe i përgjumur.

- Alban, çfarë të të blejë xhaxhi? - e pyes, kur u afruam te një minimarket.

E ula në tokë dhe e afrova para vitrinave të zgjidhte nga shumëlloj ëmbël-sirat që dukeshin. Albani kaloi vitrinë më vitrinë, i hutuar dhe herë pas here kthente kokën nga e ëma, sikur donte t'i thoshte: "Mos jam në përrallë"? Sa ndryshonte ky fëmijë nga Vasenka e asaj mbrëmje në Glifadha, që thërri: Mama, kjo është jeta!... Kurse Albani, po të ishte pak më i rritur mund të thoshte: "Mama, pse mua më mungojnë gjithë këto?"

I bleva ç'munda nga ato ëmbëlsira që shihte, aq sa ai nuk i mbante dot me ato duart e vogla. Ai shihte herë nënën e herë babanë.

- Ç'bëre kështu? E teprove! - më tha Bashkimi.

- Kjo s'është asgjë, i dashur mik, - ia ktheva, - Ajo që më lëndon shpirtin është fakti që Albani dhe fëmijët tanë meritojnë më shumë...

Bashkimi heshti, ndërsa unë shikoja rrudhat e shtuara në ballin e tij...

"Kush ua mori gëzimin fëmijëve tanë?!", - mendova dhe sërish rroka kokën e Albanit të vogël.

NJOFTIM

Për fillimin e regjistrimeve për rekrutimin e të rinjëve që duan të shërbejnë në FA

Ministria e Mbrojtjes ka hapur regjistrimet për 250 të rinj dhe të reja që duan tu bashkohen Forcave të Armatosura. Regjistrimi i kandidatëve për këtë fazë do të vijojë deri me 25 shkurt 2016. Më pas, testimet do të zhvillohen në Qendrën e Personel-Rekrutimit (QPR) që nga data 1 mars 2016.

Kriteret e përgjithshme për rekrutimin e ushtarëve /detarëve aktiv në FA

a). Për t'u rekrutuar në Forcat e Armatosura si ushtar/detar aktiv shtetasit shqiptarë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale.
- Të mos jetë në ndjekje penale.
- Të mos ketë humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit ose veprimtarisë në administratën publike me vendim gjykate.
- Të mos jetë në proces gjykimi penal nga Gjykata
- Mosha minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtar/detar aktiv, nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar ose të lartë brenda ose jashtë vendit.
- Të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtar/detar aktiv nga Spitali Ushtarak i Komandën Mbështetëse.
- Të ketë kaluar testin, fizik, intelektual dhe psikologjik.
- Kandidatët për ushtar/detarë aktiv të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat.
- Specifike
- Kandidatët për ushtar aktiv, të planifikuar për kompletimin e Policisë Ushtarake, duhet të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt dhe femra.

b). Për rekrutimin sipas specialiteteve të veçanta, veç këtyre kriterëve të aplikohen edhe kriteret specifike për aftësitë profesionale dhe parametrat fizikë, të cilat përcaktohen me një udhëzim të veçantë të SHSHP.

Procedura e aplikimit për ushtar/detar aktiv.

a) Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtar/detarë aktiv, do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit të Qendrën e Personel Rekrutimit.

b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit dhe pranimit të dokumentacionit dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimit e përzgjedhjes.

c) Procedurat, kriteret, rregullat e testimit bëhen publike në faqen e internetit të Forcave të Armatosura.

Regjistrimi i kandidatëve dhe dokumentacioni i nevojshëm

a) Kandidatët për ushtar/detar aktiv, paraqesin në Qendrën e Personel Rekrutimit, dokumentet

e mëposhtme:

- Kërkesë me shkrim, në të cilën parashtrohet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtar/detar aktiv, njësia apo reparti në të cilin do të dëshirojë të shërbyer. Aftësitë, përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara.
- Fotokopjen e kartës së identitetit
- Certifikatë familjare.
- Dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm
- Fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar ose të arsimit të lartë të noterizuar dhe të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale/Rrethit.
- Diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), të noterizuar.
- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga prokuroria.
- Vërtetim nga gjykata.
- Fletë të ekzaminimit mjekësor nga Spitali Ushtarak i Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse.

b) Të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet e përcaktuara nga ligji, kanë dokumentacionin konform kërkesave dhe janë vlerësuar të aftë nga ana shëndetësore, regjistrohen në QPR sipas rregullave të përcaktuara dhe marrin njoftim mbi pranimin si kandidat.

c) Qendra e Personel Rekrutimit, vijon procedurat e testimit dhe përzgjedhjes me kandidatët, të cilët janë gjykuar të aftë nga ana shëndetësore.

b) Të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet e përcaktuara nga ligji, kanë dokumentacionin konform kërkesave dhe janë vlerësuar të aftë nga ana shëndetësore, regjistrohen në QPR sipas rregullave të përcaktuara dhe marrin njoftim mbi pranimin si kandidat.

c) Qendra e Personel Rekrutimit, vijon procedurat e testimit dhe përzgjedhjes me kandidatët, të cilët janë gjykuar të aftë nga ana shëndetësore.

Fazat dhe procedurat e konkurrimit.

Për t'u rekrutuar në FA, të gjithë aplikantët duhet të plotësojnë disa standarde për edukimin, gjendjen fizike dhe shëndetësore. Zhvillimi i konkurrimit parashikon:

- a) ekzaminimin shëndetësor
- b) testimin fizik
- c) testimin intelektual
- d) testimin psikologjik

Periudha e regjistrimit të kandidatëve deri më 25 shkurt 2016.

ADRESA:

Qendra e Personel Rekrutimit, Rruga e "Dibrës" (Ish-Shkolla e Bashkuar), Tiranë

Kontakt: ++ 355 42 34 85 88

Veprimtari në vigjilje të Vitit të Ri 2016

Ministrja Kodheli uron fëmijët e ushtarakëve të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë të Forcës Tokësore

Kolonel Hysni Gjergji

Për Komandën e Forcës Tokësore dhe efektivat e Batalionit të Dytë të Këmbësorisë e premtja që kaloi ishte një ditë e veçantë. Me rastin e festave të fundvitit, efektivat e këtij batalioni u vizituan nga ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, e cila kishte vendosur që këtë ditë ta ndante me fëmijët e ushtarakëve të këtij reparti që është një ndër asetet më të mira dhe proritar për Forcat tona të Armatosura. Përveç ministres së Mbrojtjes, në aktivitet merrnin pjesë edhe komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, zv/komandanti i FT gjeneral brigade Muhamet Bucpapaj, komandanti i b2k, kolonel Ylli Pulaj, si dhe efektivë nga ky repart.

Kjo ishte dita e fëmijëve të ushtarakëve dhe si e tillë ishte konceptuar që të ishte nga ata dhe për ata. Gjithçka iu la në dorë fëmijëve, për këtë arsye edhe moderimi do të kryhej nga vogëlushja Fjona Pulaj, vajza e kolonel Ylli Pulajt, i cili ishte dhe në krye të organizmit të këtij aktiviteti me të vërtetë të këndshëm. Vogëlushja Fiona e kreu "detyrën" e caktuar nga babai në mënyrë të mrekullueshme. Programi parashikonte këngë dhe valle nga fëmijët e ushtarakëve të b2k, si dhe përshëndetje për të pranishmit nëpërmjet recitimit të vjershave nga vetë fëmijët. Atmosferë dhe emocione të veçanta, përcollën tek pjesëmarrësit në këtë aktivitet recitimet e vjershave nga vogëlushët Andra Vuksaj, Djola Noka, Euglen Pana etj.

Grupi i valleve të shkollës 9 vjecare "Osman Myderizi," me koreografinë e valleve me motive nga Shqipëria e Mesme, por edhe kërcimet moderne, elektrizoi të gjithë sallën. Emocioneve të kësaj dite të veçantë, që përcollën fëmijët e ushtarakëve të b2k, me performancën e tyre natyrshëm nuk mund t'iu shmangej as ministrja e Mbrojtjes, znj. Kodheli, e cila duke i përshëndetur dhe uruar festat e fundvitit për të gjithë të pranishmit, ndër të tjera tha: "...fëmijët janë arsyeja pse ne jetojmë, punojmë, luftojmë, sakrifikojmë që t'iu sigurojmë të ardhmen. Këtë gjë ju efektivët e b2k, më mirë se kushdo e bëni çdo ditë. Meraku i prindërve, nënave dhe baballarëve është i njëjtë. Ju efektivët e b2k keni zgjedhur një profesion që kërkon më shumë sakrifice, por që është edhe me dinjitoz. Dinjitetin tuaj e mban lart puna juaj dhe sukcesi i punës tuaj dhe i eprorëve tuaj."

Zonja Kodheli gjeti rastin të uronte dhe një herë gjeneral brigade Cahanin për emërimin e tij në krye të Forcës Tokësore, si dhe kolonel Ylli Pulajn për emërimin e tij në krye të Batalionit të Dytë. Ajo shprehu besimin e plotë se me aftësitë që këta ushtarakë të spikatur të Forcave të Armatosura zotërojnë, do të rrisin edhe më tej nivelin profesional të efektivave të Forcës Tokësore për të qënë gjithmonë krenarë dhe të barabartë mes të barabartëve me kolegët e tyre të NATO-s. Ministrja Kodheli e mbylli fjalën e saj duke uruar të gjithë pjesëmarrësit në aktivitet me rastin e festave të fundvitit, festa sa më të gëzuara, sa më të lumtura për ta dhe familjet e tyre.

Më tej, aktiviteti vazhdoi me ndarjen e dhuratave nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe komandantit të FT, për fëmijët e ushtarakëve të b2k, të cilëve kjo ditë do iu ngelet gjatë në memorje, si një nga ditët më të bukura të jetës së tyre.

